




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Procesverbal

Nga Seanca e XVIII (tetëmbëdhjetë) e Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, mbajtur më 30.5.2011 me këtë:

REND PUNE

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të kuvendit dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

1. Shqyrtimi i propozimeve për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gjiçanit,
2. Propozim vendimi për qasjen e plotësimit të Planit Rregullues Urban: "Fidanishte",
3. Propozim vendimi për qasjen e hartimit të Planit Rregullues Urban: "Livadhet e Arapit",
4. Propozim vendimi për anulimin e pjesërishëm të vendimit të KK-së 01.Nr.7840 të datës 14.07.2009,
5. Lista e projekteve prioritare për vitin 2011,
6. Informatë në lidhje me zbatimin e Planit Urbanistik në Zonën Industriale, (rruga e Bujanovcit),
7. Informatë për vlerësimin e aseteve të KRM "Higjiena",
8. Raport nga takimi i KKS
9. Propozim vendimi për lirim nga pagesa për leje ndërtimore për kategorinë e qytetarëve të dëmtuar nga tërmeti,
10. Informatë rreth gjendjes energjetike në komunë,

5. Të ndryshme,

Seanca filloi punimet në ora 13.20 min

Kryesuesi i Kuvendit
Izmi Zeka

Të pranishëm në punimet e Seancës së tetëmbëdhjetë (XVIII) ishin:
Anëtarët e Kuvendit
Drejtorët e drejtorive
Përfaqësuesit e OSB-së

Mediet dhe të gjithë të pranishmit e tjerë

Seancën e tetëmbëdhjetë (XVIII) e hapi dhe udhëhoqi, kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit në sallë, kurse në vijim të punimeve theksoi se ne për këtë seancë e kemi një rend pune i cili është aprovuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, mirëpo pikën e rendit të punës: informatë rreth gjendje energjetike në Komunë duhet ta heqim nga rendi i ditës, sepse përfaqësuesit e KEK nuk janë të pranishëm. Arsyeja pse mungojnë përfaqësuesit e KEK-ut nuk dihet, prandaj kjo pikë duhet të hiqet nga rendi i punës.

Para se të fillojmë me rend të punës e lus sekretarinë që ta konstatojë praninë e anëtarëve të Kuvendit në këtë seancë.

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në këtë seancë munguan: Tefil Ibrahimimi dhe Jehonë Hyseni

Pasi që kishte kuorum për të vazhduar me punë, fjalën i pari e kërkoi:

Ejup Haziri- edhe për pikën nëntë të rendit të ditës po theksoj se është tejet e qëlluar, por është e mangët. Unë kërkoj që edhe kjo pikë së bashku me pikën e dhjetë (10) të rendit të punës të hiqet nga rendi i punës dhe të na vijë lista e personave për sa bëhet fjalë dhe kush janë ata? Ditën që miratohet, kjo pikë të jetë complete dhe le të dihet se kush janë ata që lirohen nga kjo taksë? Ne po kërkojmë vetëm që lista të jetë complete.

Sokol Haziri- unë dhe ne të gjithë e dëgjuam që u tha se për pikën e 10 (dhjetë) të rendit të punës nuk mund të debatohet dhe të hiqet nga rendi i ditës. Unë pajtohem që mos të debatohet për këtë pikë, por të konstatohet se KEK-u nuk i përgjigjet dhe nuk bashkëpunon me KK-në në Gjiilan. Unë e di që hierarkia ekziston, por ne nuk kemi kërkuar raport prej tyre, por kemi kërkuar informacion lidhur me gjendjen energjetike në Komunën e Gjiilanit. Ne e dimë se qytetarët trajtohen shumë keq nga kjo Kompani, sepse ka shkyçje kolektive dhe atë me regjione të tëra dhe nuk eliminohen defektet për shkak të mospagesës nga një grup i caktuar i qytetarëve. Çështja e energjisë është individuale dhe është çështje e kontratës në mes konsumatorit dhe KEK-ut dhe nuk ka të bëjë me të drejtat e qytetarëve.

Për këtë unë kisha propozuar që në procesverbal të konstatohet: që nuk iu është përgjigjur ftesës së KK-së, menaxheri i KEK-ut, distribucioni në Gjiilan!

Izmi Zeka- duhet të konstatohet kjo dhe është vërtet se KEK-u nuk iu është përgjigjur KK-së edhe pse kanë premtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa se do të përgjigjen, por po shihet se premtimi nuk është mbajt!

Arben Mehmeti- më në fund edhe ne pajtohemi me një propozim të mirë të shefit të grupit parlamentar të PDK-së, prandaj edhe ne jemi që pika e 10 të shtyhet për një seancë tjetër dhe t' i kemi informatat e nevojshme.

Unë e kam bërë edhe një kërkesë në emër të LDK-së edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa e cila nuk ka kaluar në njëfarë forme, por po shihet që është shumë e nevojshme që ne si Kuvend ta debatojmë.

Ka qenë propozim që së paku 30 minuta para seancës të ketë debat me drejtorët e drejtorive. Është mirë që kjo të praktikohet, sepse në këtë mënyrë ne i shërbejmë transparencës, mirëpo kjo nuk po i pëlqen pushtetit dhe nuk ka dëshirë të debatohet aty

ku duhet. Është kërkesë e jona përsëri që të praktikohet kjo, sepse këtë praktikë e ka edhe Kuvendi i Kosovës dhe nuk duhet askush t' i frikohet këtij komunikimi!
Po theksoj se edhe në të ndryshme i kemi disa çështje të cilat duhet t' i dijë kryesuesi dhe mos të na thuhet se nuk i kemi paralajmëruar më herët.

Izmi Zeka- kjo që po thotë z. Mehmeti nuk është problematike, por duhet dërguar me shkrim kërkesën drejtorëve, kurse drejtorët përgjigjen kur të vijnë në seancë, sepse ata nuk mund t' i kenë dokumentacionin aty për aty.

Arben Maliqi- edhe ne grupi i AKR-së pajtohemi që pikën e 10 të rendit të ditës ta heqim nga rendi i punës, sepse nuk ka kaluar as në drejtorinë përkatëse në të cilën duhet të kalojë. Gjithashtu edhe unë kam një kërkesë që në lagjen time "Dardania" bëhet vozitje enorme dhe ka ndodh që së paku 5-6 persona e kanë humbur jetën dhe iu lus merrini masa dhe t' i vendosni policët e shtrirë në atë lagjeje. Këtë po them që mos të vijë deri tek ndonjë vdekje tjetër, këtë duhet ta keni parasysh gjithë kuvendarët dhe ju të tjerët!

Zijadin Maliqi- atë që e tha z. Arbeni edhe unë shumë para kësaj seance e kam kërkuar, por sot e kam një kërkesë tjetër, sepse dihet që përmes mjeteve të informimit është bërë shumë fjalë për një tender të cilin e ka shpallur Komuna. Ky tender ka qenë për unifikim të mbishkrimeve të lagjeve, rrugëve dhe shesheve për të cilin tender është shkruar mjaft, por është implikuar edhe Zyra për Antikorrupsion, mirëpo ne nuk jemi të njoftuar se për çka bëhet fjalë në këtë rast.

Për këtë rast kemi edhe pyetje nga qytetarët se për çka bëhet fjalë? Ne kërkojmë që për takimin e ardhshëm të na epet një sqarim për këtë rast?

Izmi Zeka- në seancën e ardhshme do të epet një informatë për këtë rast.

Sa i përket lirimit nga pagesa të njerëzve të dëmtuar nga tërmeti në kategorinë 4b, ka qenë një vendim i cili ka liruar nga taksat ata që i kanë pasur shtëpitë e dëmtuara në kategorinë 4b. Ne e kemi riaktivizuar këtë, sepse ka kërkesa të shumta të atyre familjarëve të cilët nuk janë ndihmuar nga askush. Ata familjarë së paku kanë kërkuar që të lirohen së paku nga pagesa për dhënie të lejeve. Kjo listë complete është në Drejtorinë e Gjeodezisë dhe kjo është shumë e qartë.

Ejup Haziri- ne nuk kemi asgjë kundër dhe e thash se është një vendim pikërisht si duhet. Mirëpo ata kanë pritur që disa vite, ne jemi duke pritur vetëm një muaj, deri në seancën tjetër? Para se të vijë në seancën tjetër, Drejtoria e Urbanizmit le të na e dërgojnë listën dhe ta dimë saktë për ke bëhet fjalë? Ne vetëm listën po e kërkojmë, kur është pritur me vite edhe një muaj nuk do të bëhet asgjë!

Izmi Zeka- kjo punë vetëm mund të zvarritet, ne mund sot ta aprovojmë, kurse listën e sjellim në seancën e ardhshme! Bëhet fjalë vetëm për shtëpitë e dëmtuar në kategorinë 4b e të cilët nuk kanë përfituar asgjë! Ne e kemi aprovuar këtë në KPF dhe kjo është shumë e qartë.

Arben Mehmeti- vetëm një përmirësim, sepse për këtë pikë nuk jemi marrë vesh me shefat e grupeve parlamentare, por kjo ka ardh në KPF, me propozim të kryetarit të Komunës. Këtu po shihet se ka mosmarrëveshje në mes drejtorit, kryetarit dhe

kryesuesit , prandaj qëndrimi i 24 anëtarëve të Kuvendit është që shtyhet kjo pikë e rendit të punës.

Izmi Zeka- faleminderit për sugjerime, por kjo në KPF ka kaluar !

Arben Malqi- unë gjithmonë kam dhënë lëvdata për këtë Kuvend, që është demokratik dhe ka një performancë të mirë, prandaj kanë të drejt ta marrin fjalën të gjithë edhe drejtoresha le ta thotë fjalën e vet, prandaj këso lloj sjellje mua nuk po më pëlqejnë. Është mirë të mos krijojmë tensione, këtu nuk ka të keqe asgjë, kjo është për të mirën e qytetarëve.

Izmi Zeka- unë po e shtyj, por nuk po e kam të qartë pse po shtyhet? Edhe një herë po e sqaroj? Kategoria 4b të cilët nuk kanë përfituar, as prej OJQ-ve dhe as prej institucioneve komunale, ata lirohen prej pagesës së lejes kjo është e qartë. Kategoria 4b është vlerësuar prej një grupi të ekspertëve, dokumentacionin e ka Drejtoria e Urbanizmit dhe këtu nuk ka dilemë. Këtë po dëshirojmë t' i mundësojmë në mënyrë ligjore që ata njerëz ta gëzojnë atë të drejtë, sepse nuk kanë gëzuar asnjë të drejtë me rastin e dëmeve nga tërmeti.

Elisah Ymeri- edhe unë desha ta plotësoj se me të vërtetë kjo është me rëndësi dhe ka vërejte, prandaj vlen të shtyhet, sepse këtu thotë që:” pronarët e objekteve ekzistuese për të cilët pretendohet se kanë pasur leje ndërtimore me plane ndërtimore urbanistike” Mirëpo ne e dimë që në fshatra ka shtëpi të dëmtuara dhe aty nuk ka plane detale urbanistike, por edhe në qytet ka plotë shtëpi të vjetra të cilat nuk kanë plan të këtillë. Kjo çështje duhet të definohet mirë, pastaj të aprovohet në Kuvend.

Sokol Haziri- unë e kërkoja fjalën, sepse ne si grup politik nuk u deklarua për këtë pikë të rendit të punës. Në Komitetin për Politikë dhe Financa kjo pikë ka kaluar në mënyrë unanime , mirëpo këto gjëra që po ndodhin po shihet se ka mosharmonizim të dukshëm në mes të grupit të juaj të këshilltarëve dhe drejtorisë përkatëse. Ajo listë që po kërkohet, ajo ekziston, nuk është listë që duhet të bëhet dhe drejtoria përkatëse ka qenë desh sot ta ketë listën sot, ose ka qenë desh ta ketë së bashku me materialin për seancë. Prandaj një praktikë të tillë nuk më pëlqen fare, sepse kjo i shërben mos efikasitetit të punës së Kuvendit. Unë jam për atë që sot definitivisht ta debatojmë këtë pikë.

Bahrie Mahmuti - këtu është fjala për pikën një dhe nëse atëherë ky vendim nxirret për interesa të pronarëve të cilët kanë përfituar nga ndihmat për kat. 4b, atëherë pika katër bien ndesh me të parën, sepse sipas ligjit të ndërtimit të gjitha objektet të cilat kanë leje ndërtimore ato e gëzojnë të drejtën që në bazë të atij gabariti që e kanë pasur lejen, mund ta shfrytëzojnë lejen e mëparme.

Pikën e parë duhet hequr, sepse këta automatikisht e gëzojnë të drejtën e ndërtimit.

Ejup Haziri- qëndrimi që e dha grupi i PDK-së ishte shumë i qartë, mirëpo debatet që u bënë e krijuan tensionin! Ne kërkuam punë më tepër prej ekzekutivit, sepse ne jemi pozitë dhe ne vetëm deshëm të jetë pikë komplete. Të shtyhet pas dy-tri jave ta kemi një listë definitive me të gjithë ata njerëz që lirohen prej taksave dhe që realisht të eliminohet mundësia që në të ardhmen të gabojë dikush. Është dokument bazik me të cilin merret vendimi dhe secili prej neve ta ketë atë dokument. Unë nuk e di kush pa mos unitet në grupin e PDK-së? Ky është shumë grup unik!

Izmi Zeka – kush është që miratohet rendi i punës duke e hequr pikën 10(dhjetë) dhe 9 (nëntë)

Aprovohet rendi i punës në mënyrë unanime me propozim që të hiqet nga rendi i punës pika 9 dhe 10

Procesverbali-

Sarandë Bllaca- f. 26 fjalia e ime është në gjysmë, sepse unë kam kërkuar që të barazohet fakulteti privat me atë publike, në qoftë se ndryshohet pika 5, nëse bëhet poentomi i studentëve të familjeve të dëshmorëve.

Shpresë Hajdari- faqe 28 në procesverbal thuhet se ne po i mbajmë nga dy mbledhje, prandaj fjala ne duhet të jetë: ‘ ju po i mbani nga dy mbledhje’

Aprovohet procesverbali me këto dy vërejtje

Millan Stojanoviq- dëshiroj t’ i përshëndes të gjithëve, së pari kryesuesin e Kuvendit z. Izmi Zeka, kryetarin e Komunës, të gjithë këshilltarët, drejtorët dhe të gjithë të pranishmit. Unë nuk e di sa z. Nuhiu do të arrijë t’ i përkthej fjalët mia, por shpresoj se do të jemi i qartë. Unë si nënkryetar për komunitete i kam përcjell të gjitha punimet të cilat kanë ndodhur në KK- të Gjilanit.

Mendoj se në këtë periudhë jemi në një situatë mjaft brengosëse, jo për shkak të raporteve në mes të komuniteteve, por unë dua të flas vetëm për qytetarët e Kosovës për interes të cilëve do të bëhet mirë, për qytezat e Kosovës, Gjilanit, Anamoravës dhe të gjithë neve. Unë do të jemi shumë i shkurtër dhe për 5 minuta do t’ i përmbledh të gjitha problemet e 10 vjetëve të fundit.

Mund të them se Beogradi në 10 vjetët e fundit me neve serbëve të Kosovës ka udhëhequr politikë jo të mirë dhe të mjaft të gabuar. Ne me këtë politikë jemi diferencuar, por Beogradi ka arrit që ta mbajë një monopol në Mitrovicë dhe Prishtinë, Ajo politikë është e dështuar e Ballkanit, ne patjetër duhet të inkuadrohemi në një politikë evropiane. Unë i kam thënë kryetarit Tadiq që kur ai vjen në atë moment ai ne gëzohemi, por posa të shkojë ne dëshpërohemi! Ne i kemi marrë gjërat në duar tona. Megjithatë sa unë po shoh, shoqëria kosovare ende po e zbaton praktikën e Ballkanit. Çka do të thotë ngjarje të Ballkanit? Secili njeri dhe secila komunë tërheq nga ana e vet. Duhet ta kemi parasysh se sa më parë të gjithë duhet të shkojmë në Bashkimin e Evropian dhe duhet vepruar ashtu si vepron Evropa.

Nëse ne të gjithë i pranojmë përrallat dhe nëse gjërat i shikojmë vetëm në një drejtim me siguri se gjërat nuk do të shkojnë përpara.

Cilat janë problemet sot në Anamoravë dhe Gjilan? I kemi 11 deputet nga KK- Gjilani, prej të cilëve i njoh dy- tre, por asnjë prej tyre në kohët e fundit nuk e kanë ngritur zërin për problemet tona të Anamoravës. Fatkeqësi që nuk e kemi asnjë ministër dhe kjo nuk është me rëndësi se cilit komunitet i takon, por fatkeqësi është që ne nuk kemi ndonjë lobim për Anamoravën. Nga kryetari i Komunës Qemajl Mustafa dhe kryesuesi i Kuvendit Izmi Zeka kërkoj urgjentisht ta formojnë një lobim dhe të shikojmë çka të bëjmë më tutje. Duhet urgjentisht të veprojmë, sepse dita ditës Gjilanin mund ta sjellim në ndonjë dështim. Kam një shembull se si Komuna jonë për pagesë të tatimeve është e

para, por nga 42 komuna tjera, komuna jonë sa i përket investimeve gjendet në vendin e 38.

Kjo është turp dhe ne patjetër duhet t' i shtrojmë pyetje vetes se çka duhet bërë më tutje? Unë kërkoj që të harrohen interesat partiake dhe të inkuadrohen të gjitha partitë PDK, LDK etj dhe të konsultohen edhe deputetët, kryetari i Komunës dhe të fillojnë me projektin e auto udhës dhe projekteve të tjera me rëndësi. Unë në jetë kurrë nuk kam qenë si humbës dhe as që do të jem ndonjë politikan humbës.

Do ta them një shembull konkret, komuna e ime fqinje Kamenica po e ndërton një palestër sportive dhe ka pasur sukses që ta rregullojë tri herë, kurse për këtë palestër harxhohen 7.5 milion euro. Kjo është një rrëfim ballkanik, prandaj unë si kryetar për komunitete, sipas Planit të Ahtisarit edhe pse i kemi pranuar të gjitha institucionet dhe që e kam sjell si mysafirë Agim Çekun në Shillovë dhe forcat e sigurisë etj. Ne si pakicë në Gjilan asnjë euro nuk e kemi marrë për investime, kurse në komunat e tjera serbe si në Graçanicë dhe të tjerat marrin nga dy milion e më tepër grande qeveritare. Për këtë është një pakënaqësi e madhe edhe në bashkësinë time dhe në komunë. Unë kam insistuar që serbët të paguajnë tatimet dhe komunalit, ne duhet t' i përgjigjemi të gjitha çështjeve të cilat janë të shtruara konkret tek Hashim Thaqi dhe Piter Fejt, sepse ato janë dy figura që mund ta kthejnë ardhmërinë dhe perspektivën. Ka edhe shumë të punohet dhe kam preferencë për komunitetin shqiptar që kur të jetë në pyetje standardet e dyfishta do ta jap një shembull lidhur me arsimin. Edhe përkundër bashkëpunimit të mirë me z. Bujar Nevzadin i kemi dy standarde të dyfishta. Unë kam tentuar që t' i largojë të gjithë ata që i marrin dy paga, kryetari njëherë e ka pranuar, herën tjetër jo ! Kur e analizojmë thellë nuk është problem komuniteti serb, por komuniteti shqiptar nuk e din se çka dëshiron? Kemi problem në Shillovë ku e kemi hapur një çerdhe i kemi punësuar 10 njerëz, profesorët i marrin nga dy paga, ata marrin paga nga institucionet e Kosovës, por edhe Komuna paralele në Kuscë kanë bojkotuar, kurse Qevria e Kosovës i paguan! Kurse në anën tjetër bojkotojnë dhe nuk i lejojnë fëmijët të regjistrohen në kopshtin e fëmijëve. Ky është vetëm një shembull, por kemi shembuj të tillë edhe në arsim, kurse në shëndetësi e kemi një radikal të cilin e kemi shpërblyer i cili merr pagë edhe nga Serbia dhe nga Qeveria e Kosovës. Nëse vazhdojmë kështu me të keq po e them do të përsëritet ajo periudha e viti 1999. Unë nga ju kërkoj mirëkuptim dhe përkrahje.

Kërkoj nga kryetari i komunës, nga kryeministri Hashim Thaqi të vënë pikë dhe të dihet ku është qëllimi? Kjo që është nuk i ngjan asgjëje, por më tepër i ngjan cirkusit!

Në anën tjetër ju duhet ta keni parasysh se fjala ime është qëllim mire dhe kur vitin e kaluar pata thënë se Komuna e Gjilanit është lënë në harresë është thënë se jam njeri i mirë, por politikan i keq. Unë e them nga kjo foltore se rruga e vërtetë nuk kërkon shumë dije dhe diskutimet e mia janë qëllim mira dhe dëshiroj që Gjilani të jetë qytet evropian si ka qenë dhe jo të mbetet një pikë e zezë në Evropë!

Ju faleminderit për durim.

Izmi Zeka- kjo fjalë e zv/kryetarit për komunitete ishte mjaft një debat i mirë, sepse ne me të vërtetë duhet ta rregullojmë çështjen e arsimit dhe të shëndetësisë, por edhe drejtori i Arsimit është në bisedë me të vazhdimisht dhe drejtori është në ngjarje, por institucionet e Gjilanit janë duke punuar natyrshëm edhe me komunitetet.

Sokol Hairi- unë desha në emër të AAK-së ta përshëndes dhe ta përgëzoj fuqishëm fjalën të cilën e paraqiti zv/kryetari për komunitete. Dëshiroj që këta shembuj pozitiv që janë në Kosovë të merren në konsideratë dhe definitivisht jam i impresionuar me fjalët që u

thanë dhe do të kisha desh që nëse janë fjalë të vërteta të qëndrojnë prapa tyre, por edhe Komuna me të gjitha kapacitete e veta t' i jep mbështetje të gjitha këtyre qëndrimeve, sepse ky është edhe interes i komunitetit shumicë dhe atij pakicë.

Ju e dini se vetëm një fshat ka mbetur me decentralizimin si pjesë e Komunës së Gjilanit dhe vëmendja e Komunës së Gjilanit duhet të kthehet jo vetëm nga komuniteti në Shillovë, por edhe komunitete tjera që janë në Mireshe dhe të tjerat që janë në Komunë të Gjilanit.

Ejup Haziri- unë desha ta përshëndes nënkryetarin dhe ta inkujaroj si një politikan të guximshëm edhe i kisha preferuar që të vazhdojë kështu dhe mos të lëshoj pe, sepse ky është një politikan që i vyen perspektivës.

Arben Mehmeti- debati i tij është i mirë, por në bazë të asaj që unë kam informata se në ngjarjet e fundit që kanë qenë ka rezultuar me një aspekt negativ. Nga informatat që i kam lidhur me regjistrimin e popullsisë del se një numër simbolik i komuniteti serb janë regjistruar. Nga kjo nënkuptohet se nuk pranohen institucionet dhe nënkryetari i Komunës është mirë ta ketë edhe këtë fakt dhe nuk është mirë këtu të na mbajë vetëm ligjëratat, por duhet edhe në terren të veprojë praktikisht, pastaj të vijë me rezultate këtu?

Arben Malqi- edhe unë e përgëzoj kryetarin, por dua t' i them që biznesi dhe politika kanë dallim shumë të madh dhe politika nuk është 100 metërsh, prandaj nuk duhet thënë shumë fjalë.

Sabedin Kadriu- desha ta uroj nënkryetarin dhe po them se rastësia është mbret i botës, por e thash se nënkryetari nuk e ka pasur as babanë as gjyshin politikan dhe as vet nuk do të bëhet politika. Rastësisht ia njoh edhe gjyshin edhe babanë, por është një njeri me elan, mirëpo Gjilani nuk është as Kamenicë as Viti, por ndoshta është njeri i drejtë, por politikan nuk është fare.

Jakup Bajrami- ne e dëgjuam fjalën e nënkryetarit, por dëshiroj që bashkëpunimi të jetë edhe më i mirë edhe me komunitete tjera në mënyrë që të jenë më aktiv, kurse sa i përket investimeve të cila ti përmendi edhe ne si Kuvend i kemi trajtuar këto dhe i kemi dhënë mendimet e tona. Është mirë që në emër të komunitetit kërkesat të cilat i përmendi, janë shembull për së mirë, prandaj do ta ketë përkrahjen, por edhe ne i kemi ato vërejtjet tona se me të vërtetë Komuna e Gjilanit është lënë anash.

Një shembull që e përmendi edhe ne si qytetarë të Gjilanit e kemi dhënë vërejtjen tonë, sidomos për autostradën e cila duhet të fuqizohet dhe të kthehet kah është interesi i qytetarëve të Kosovës, prandaj unë i jap mbështetje të fuqishme .

Bujar Nevzadi – unë po iu njoftoj se ne kemi bashkëpunuar mirë me komunitetin serb, për të cilën punë e përgëzoj nënkryetarin për një pjesë të punës së mirë të cilën e ka bërë. Kemi emëruar u.d të drejtorëve nëpër shkollat serbe, mandej kemi shpallur konkursin për punëtorë të arsimit dhe punëtorë ndihmës. Nënkryetari ka disa vërejtje në Partesh, gjëja se janë punësuar disa njerëz, por nuk shkojnë në shkollë dhe marrin rroga!

Pa punuar marrin rroga, do të thotë njerëz të cilët nuk kanë kryer shkollë. Ne normalisht nuk jemi pajtuar kemi shpallur konkurs, kurse komisioni i ka pranuar ata të cilët i kanë plotësuar kushtet. Këta e kanë një numër të madh të cilët i paguan Serbia, por ajo është çështje e tyre, por tek ne i kanë 90 norma dhe ne jemi marrë vesh. Në kohën e fundit

kryetari i Komunës ia ka mundësuar edhe 15 norma dhe e ka marrë për sipër që të bisedojë në ministri dhe t' i sistemojë këta njerëz.

Vërejtje e jona është që ne nuk jemi pajtuar që njerëzit të cilët nuk punojnë të marrin të ardhura personale!

Kjo është vërejtje jonë, për kuvendarë, gazetarë dhe çdo kush mund të vijë në DA për t' i parë punët që janë bërë dhe kërkesat të cilat i ka pasur nënkryetari për komunitete.

Xhemajl Salihu- ne lidhur me rastet e shëndetësisë kemi biseduar disa herë, por kësaj here po e njoftoj KK-në. Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 10 serbë, të gjithë kanë kontrata të punës. Vitin e kaluar e kam hapur një konkurs për një mjek serb dhe asnjë nuk i ka plotësuar kushtet, në fakt nuk është paraqitur asnjë. Kusht themelor për të ushtruar detyrën e mjekut është që mjeku duhet të ketë licencë të Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës. Këtë vit kemi desh ta krijojmë një vend të punës së mjekut, por nënkryetari nuk ka pasur mundësi të dëshmojë se doktori që punon posedon licencë të punës. Unë nuk mund të lejojë që dikush të themelojë vend të punës pa dokumentacion valid. Kjo është përgjigja e ime.

Millan Stojanoviq- e përshëndes drejtorin e arsimit dhe atë të shëndetësisë, sepse ata po e thonë rrëfimin të cilin atyre iu përgjigjet. Unë mund të flas me orë të tëra dhe të them se ajo është absurd. Nëse drejtorët nuk bëjnë punën tyre drejtë, sigurisht se të gjithë do të shkojmë kah më e keqja. Sot nuk do të merrem me ata, drejtori i shëndetësisë e di se disa mjekë e kanë marrë licencën në janar. Drejtori i shëndetësisë ka punësuar disa njerëz sipas lidhjeve familjare, por sot nuk dua të merrem me z. Bujari, por dua ta marrë fjalën së paku nga 10 minuta në secilën seancë ku do të flas për dukuri në arsim dhe shëndetësi. Mirëpo dua t' i përgjigjem e z. Arben nga LDK, sepse unë e di se z. Arbeni tërë kohën është në Kosovë dhe jeton qe 42 vjet, por nuk e di se mos e ka zënë gjumi si këshilltarë. A e din z. Arbeni që këtu ka dy komuna serbe të cilat i ka Gjilani, njëra paralele dhe kjo e vërteta? Lidhur me regjistrimin e popullatës në tërë Anamoravën më 2006 janë dal në zgjedhje vetëm 8 serbë. Mirëpo tash kanë dal 12 mijë serbë, prandaj duhet atyre njerëzve t' i epet ndihmë morale dhe materiale për të treguar se Qeveria e Kosovës është e interesuar për t' i integruar. Ne nuk po kërkojmë miliona euro në Gjilan, për komunitetin serb, por investime simbolike për të parë se jeni të interesuar që të mbesim në Kosovë. Ne absolutisht nuk jemi për ndarje të Kosovës, sepse këtu ka vend për të gjithë njerëzit qëllim mirë.

Unë kam kërkuar nga kryetari i Komunës, që të ulemi së bashku me 11 deputet dhe të bisedojmë dhe të shikojmë si është bërë regjistrimi deri në fund. Deputet tanë në Kuvend falsin ndryshe, kurse në terren veprojnë ndryshe. Edhe një herë po e them nuk është problem komuniteti serb, por është komuniteti shqiptarë, sepse sigurisht se do të vijnë serbët e mençur në pushtet.

Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa

1. Shqyrtimi i propozimeve për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gjilanit,

Izmi Zeka- lidhur me këtë pikë po theksoj se ndryshimet dhe plotësimet e Statutit janë bërë, gupet parlamentare janë pajtuar, në komitetin për Politikë dhe Financa ka kaluar, kurse unë kërkoj nga shefi i Zyrës ligjore që para anëtarëve të Kuvendit të na japin një arsyetim.

Hevzi Matshi- z. Matoshi në pika të shkurtra dhe një arsyetim para anëtarëve të Kuvendit, të cilin arsyetim anëtarët e Kuvendit e kanë me shkrim së bashku me materialin për seancë.

Arben Malqi- unë fillimisht e përgëzoj komisionin i cili ka punuar mjaft mirë, sepse në këtë komision për ndryshim dhe plotësim të statut kanë qenë të angazhuar njerëzit më kompetent dhe të cilët i njohin mirë gjërat. Mirëpo unë i takoj një lokaliteti për të cilin më duhet të reagoj në Kuvend dhe të reagoj para qytetarëve të cilët ma kanë dhënë votën. Neni 10, paragrafi 1 dhe 2, kemi të bëjmë me territorin e Komunës së Gjilanit, ku nuk është përfshirë fare Kosaqa edhe Malisheva. Dihet mirëfilli që procesi i decentralizimit është një proces dhe kompromis i dhembshëm dhe mjaft tragjik. Ndarja e disa fshatrave nga Gjilani dhe bashkimi i tyre me Novo Berd i ka sjell shumë telashe qytetarëve të Gjilanit. Dihet mirë se Novo Bërda ka pasur 5 mijë, kurse tash i ka 13 mijë banorë, kurse territor ka dy herë më tepër se Komuna e Gjilanit.

Tash e tutje fshatrat që i përkasin zonave kadstrale, Golec, Dushicë, Marec, Dragancë, Kuscë e Epërme, Makresh i Epërm, Makresh i Ulët, Miganovc, Mozgovë, Parallovë, Strazhë dhe Irincë, nuk i përkasin Gjilanit, kur dihet se janë bërë 13 mijë nënshkrime kundër këtij decentralizimi. Mirëpo edhe kryetarët e komunave të Gjilanit dhe të Novo Berdës nuk e kanë prit siç duhet këtë proces! Fshatrat që janë më afër Gjilanit gjeografikisht duhet të jenë me Gjilan, aty ku i ka lënë edhe zoti është decidivë kryetari i Komunës së Novo Bërdës, z. Bajrush Imeri.

Mirëpo edhe kryetari i Komunës së Gjilanit, z. Qemajl Mustafa, zgjerimin e Komunës së Novo Bërdës me fshatrat periferike të Gjilanit e quan dështim.

Me këto ndarje do të krijohen probleme me inspeksionin, mandej me planifikim të zhvillimit urban, pasi që në kuadër të zonës kadastrale të Koretishtes futen edhe disa rripe të vet qytetit të Gjilanit të cilat iu janë bashkuar Novo Bërdës.

Unë e kam fjalën për fshatin Pasjak, Kosaqë, mandej janë edhe disa fshatra serbe të cilat e kanë shumë afër qytetin në 3-6 km, kurse me këtë proces ata duhet të udhëtojnë deri në 30 km për nxjerrje të dokumenteve. Dihet se Ligji për kufij administrativ për komuna neni 10 thotë: “mënyra e kufijve administrativ të komunave janë të cituar shumë mirë, nën a, b, c dhe d se si mund të ndahen”. Tek zonat kadastrale këtu së pari Kosaqa nuk figuron as me Gjilan, as me Novo Bërdë. I lus të gjithë të pranishmit që ta kemi parasysh këtë fakt dhe mos të mbesin Kosaqa dhe disa fshatra të tjera askund dhe të mos dihet se ku duhet nxjerr dokumentacion të nevojshëm. Këto ishin vërejtjet e mia!

Riad Rashiti- në takimin që është mbajtur herën e kaluar në Komitetin për Politikë dhe Financa, unë kam kërkuar që Malisheva e Epërme të figurojë në Komunë të Gjilanit e cila vërejte është aprovuar, por ajo tash nuk po figuron në projekt të Statutit, prandaj iu lus që ta përmirësoni.

Sokol Haziri- fillimisht po e paraqes një vërejtje në emër të këshilltarëve të AAK-së, pasi që nga përfaqësuesi i ynë në këtë komision kemi informacione shtesë që të gjitha ato vërejte që janë dhënë nga përfaqësuesi i AAK-së nuk janë marrë në shqyrtim nga ana e komisionit. Ne jemi të vetëdijshëm se vendimet merren me shumicë të votave, por megjithatë, pasi që është një vendim edhe i natyrës politike është desh që të gjendet një koncenzues për vendim marrje. Sidoqoftë kjo është një e shkuar, por si vërejtje do të mbetet. E dyta ne në KPF i kemi rekomanduar Kuvendit që të miratohet ky Statut pas debatit dhe procedurave të nevojshme të kalojë, por unë kam një vërejtje më praktike

lidhur me këto çështje dhe të gjitha ato vendbanime dhe fshatra që përmenden decidivisht me ligjin për decentralizimin të mbesin me Komunën e Gjilanit. Këto fshatra mos të mbesin me një komunë e cila është krejtësisht politike dhe është produkt i vendim- marrjes së institucioneve edhe jashtë Kosovës, por besoj se një vlerësim i këtij procesi shumë shpejtë do të ndodh dhe vetë qytetarët e përkatësisë etnike serbe do të kërkojnë që shërbimet e tyre t' i kryejnë në Gjilan dhe të mos udhëtojnë 20-30 km për një dokument të thjeshtë.

Vërejtje tjetër shumë serioze është se duhet të keni konsideratë në atë se si mundet një Kuvend Komunal mos të jetë njësi buxhetore, mos ta ketë vijën e vet buxhetore?

Kjo duhet të futet në një nen dhe të thuhet se është njësi buxhetore dhe të dihet sa e ka buxhetin e vet?

Çështje tjetër edhe pse kanë kaluar 10 vjet pas luftës, por tek neni 37 pika 12 thuhet : komunitete, por i shtohet edhe fjala kthim. Nuk ka nevojë të jetë fjala kthim, por të mbetet vetëm komunitetet të cilat janë objekt trajtimi të këtij neni.

Një çështje e cila ka të bëjë me kapacitete ekzekutive të KK-së, ne kemi konsideruar se janë të mjaftueshme këto të cilat janë dhe nuk është e thënë që të krijohen edhe drejtori të tjera shtesë dhe rritja e numrit të drejtorive më duket krejt i paarsyeshëm dhe në kundërshtim me logjikën e kursimit dhe të efikasitetit të Administratës.

Në fund po e theksoj ajo që është fundamentale është ajo se ky është një vullnet për zbatim të ligjit mbi decentralizimin dhe nuk është aspak vullnet politikë i qytetarëve të Komunës së Gjilanit.

Sadudin Berisha- prej vitit të kaluar me vendim të KK-së është themeluar komisioni për ndryshime dhe plotësime të Statutit të Komunës së Gjilanit. Ky është një detyrim ligjor që rrjedh pas miratimit të dy ligjeve sistemore që rregullojnë fushën e qeverisjes lokale dhe organizmit territorial të komunave të Kosovës, pas procesit të decentralizimit i cili ishte i dhembshëm për ne, por që ne duhet ta zbatojmë atë që duhet të ndodh. Si do që të jetë LDK, pavarësisht të miratimit të dy ligjeve sistemore edhe sot angazhohet që dy zonat kadastrale e që janë Psjaku dhe Petrovci, natyrshëm duhet t' i kthehen Komunës së Gjilanit dhe ky proces është në diskutim e sipër me mundësi që të intervenohet ligjshëm për ndryshime kualitative në mënyrë që të integrohet kjo pjesë minimalisht në kuadër të Komunës së Gjilanit. Gjithashtu edhe rishikimi dhe ndryshimet që kanë ndodh si pasojë e decentralizimit, do të rishikohen sipas ligjit me mundësi që të bëhen ato ndryshime dhe besoj se ajo do të ndodh si nevojë e konstatimit të mosfunksionimit të komunave që kanë ndodhë, qoftë në shtesë të territorit të komunës së Artanës, apo të dy komunave që veprojnë tash e disa muaj në ish territorin e Komunës së Gjilanit.

Si do që të jetë grupi i LDK-së në KK- të Gjilanit e ka marrë me shumë seriozitet punën për këto ndryshime dhe i ka mbështetur të gjitha ndryshimet të cilat nuk i cenojnë interesat e Komunës së Gjilanit e që janë në harmoni me ligjet sistemore.

Unë kam qenë pjesë e këtij komisioni së bashku me Arbenin dhe kolegët tjerë dhe takimet me komisionin dhe jashtë tij ka qenë shumë i madh, por qëllimi jonë ka qenë që të kemi një statut sa më mirë të hartuar nga Komuna e Gjilanit. Këtë e ka arritur me pjesën dërmuese të rekomandimeve dhe propozimeve që kanë ndodhur duke i bashkangjitur edhe grupimet e tjera politike. Ky plotësim dhe ndryshim ka qenë edhe në debat publik dhe ka pasur kërkesa dhe opinione të ndryshme, por ne vlerësojmë se neni 34 për ndryshimin e strukturës administrative dhe organizative brenda Komunës nuk duhet të shtohet edhe për një drejtori, prandaj neni 34 duhet të hiqet si propozim i dhënë. Vlerësimi i jonë është që nuk ka nevojë të rritet numri i drejtorive dhe mos të bëjmë si

Qeverinë e Kosovës me 19 ministri e 6 zv/kryeministra për t' i kënaq apetitet e individëve, apo grupeve të individëve. E dyta pjesa tjetër e ligjit duhet detyrimisht të lekturohet, sepse ka gabime edhe gjuhësore dhe profesionale e që nesër do të paraqiten probleme se si duhet të bëhet interpretimi i një neni të këtij statuti.

Ne mbështesim këtë plotësim dhe ndryshim të Statutit me përjashtim të neni 34 dhe detyrimisht të bëhet lekturimi. Ne thjeshtë angazhohemi që edhe më tutje fshati Pasjak dhe Petrovc të mbesin komuna kadastrale të Gjilanit.

Jakup Bajrami- unë mendoj se Statuti është dokumenti më i fuqishëm i Komunës së Gjilanit, mirëpo edhe unë jam i mendimit se Kosqa, Malisheva e Epërme dhe Pasjaku të mbesin zona kadastrale të Komunës së Gjilanit. Ndoshta ky statut do të ishte aprovuar më herët, por ka pasur vërejtje edhe nga banorët e fshatit Pasjak, por edhe qytetarë të tjerë të cilët kërkojnë me çdo kusht që ky fshat të përfshihet në Komunë të Gjilanit. Në këtë aspekt më duket se të gjithë jemi unik.

Mirëpo sa i përket organizmit të brendshëm edhe LDD mendon se neni 34 duhet të hiqet, sepse edhe ne mendojmë është një ngarkesë buxhetore nëse e rrisim numrin e drejtorive edhe për një siç është ajo për Zhvillim Ekonomik.

Ne e dimë se një sektor për zhvillim ekonomik ekziston dhe këta persona të cilët punojnë në atë sektor janë të mjaftueshëm për t' i kryer punët për projekte kapitale.

Ne mendojmë se Komuna e Gjilanit me 11 drejtori mund të funksionojë dhe mos të veprojmë si qeveria, atëherë kur ka probleme kadrovike, ngutet për të formuar ministri të reja, prandaj nuk preferoj të ndodh e njëjta gjë edhe këtu në Gjilan.

Ne nuk jemi për ta aprovuar këtë nen, prandaj të mbesin ashtu siç ka qenë.

Riad Rashti- unë mendoj se sa i përket buxhetit të Komunës, mendoj se këto gjëra nuk duhet të futen në Statut të Komunës, sepse është sistemi i përcaktuar i cili e ka të përfshirë buxhetin komunal. Ai kod ekziston edhe me rishikim të buxhetit mund të kërkojmë rritjen e buxhetit. Ndërsa sa i përket propozimit për një rritjen e numrit të drejtorive nga 11 në 12, unë mendoj se Gjilani ka nevojë për këtë drejtori e cila merret me sferën e zhvillimit ekonomik. Krijimi i një drejtorie të tillë është i mirëseardhur, sepse krijon perspektivë për zhvillim ekonomik, industrial etj.

Ibrahim Neziri- në emër të grupit i japim mbështetje komisionit për ndryshim të statutit, sa i përket përfshirjes ose mos përfshirjes së disa fshatrave në zona kadastrale të Gjilanit, ne kemi mandatin deri në fund dhe kjo mund të rishikohet edhe më vonë deri në fund të mandatit.

Hevzi Matoshi- unë i kuptoj shqetësimet e anëtarëve të Kuvendit, kanë të drejtë. Mirëpo duhet ta keni parasysh se komisioni nuk ka shpikur diçka të re. Komisioni ka bërë zbatimin e ligjit ashtu siç u tha nga parafolësit. Neni 6 mbi kufijtë administrativ përcakton zonat kadastrale. Taksadivisht janë të regjistruara të gjitha zonat kadastrale që i përkasin komunave të Kosovës, duke përfshirë edhe atë të Gjilanit.

Sa i përket emërimit të zyrave, kohën e fundit i kemi marrë dy udhëzime, një nga kryeministria dhe një nga MPL-ja, ku ceket rëndësia se Zyra për komunitete duhet t' i përshtate rrethanave aktuale dhe në çdo komunë duhet të themelohet dhe të harmonizohet me Statutin e Komunës me emrin me të cilin është propozuar në këtë rast.

Ne Statutin e kemi bërë në pajtim me ligjin dhe asgjë nuk ka në kundërshtim me ligjin, por i kemi përfshirë disa cilësi të tilla për të qenë një akt sa më cilësor.

Riad Rashiti- unë e sqarova se në KPF, është marrë vendim që të plotësohet me vendbanimin e ri Malishevë e Epërme, nëse ne kemi marrë vendim të gabuar, atëherë duhet të na epen sqarime se ky vendim i Komitetit për Politikë dhe Financa është i jashtëligjshëm.

Hevzi Matoshi- ndryshimi i zonave kadastrale nuk mund të bëhet me asnjë vendim, me përjashtim me ligjin i cili është në fuqi. Për këtë komisioni nuk ka bërë asnjë ndërhyrje sa i përket zonave kadastrale të parapara me nenin 6. Këtë duhet ta kemi të qartë.

Izmi Zeka – më duket se u debatua mjaft edhe pse komisioni i ka sjell këto ndryshime, përsëri ka sugjerime nga më të ndryshmet dhe është e pakuptimtë që tash të debatohet. Unë kërkoj që të shtyhet kjo pikë për seancën e ardhme derisa komisioni të jetë unik dhe të bëhen ato ndryshime nga anëtarët e Kuvendit.

Të gjithë e dinë se si i parasheh ligji komunat kadastrale, të gjithë kemi qenë kundër një decentralizimi të tillë e cila ka një karakter politik, por tash nuk kemi fuqi ligjore për të bërë ndryshime.

Unë po e shoh se nuk ka koncnzues për këtë dhe propozoj që kjo pikë e rendit të punës të mbetet për seancën e ardhshme.

Kush është për këtë propozim që kjo pikë të shtyhet për seancën e ardhshme?

Anëtarët e Kuvendit me vota unanime u pajtuan që pika 1 e rendit të punës: Shqyrtimi i propozimeve për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gjilanit të shtyhet për seancën e ardhshme.

2. Propozim vendimi për qasjen e plotësimit të Planit Rregullues Urban: “Fidanishte”,

Bahrie Mahmuti- znj. Mahmuti lidhur me qasjen e plotësimit të Planit rregullues të kësaj zona e dha një sqarim, të cilin anëtarët e Kuvendit e posedojnë me shkrim në material të seancës.

Florinë Zymberi- ne kemi mjaft kërkesa të qytetarëve për plotësim të destinimit të Planit rregullues në Zonën “Fidanishja” e cila është aprovuar para disa muajve.

Bazuar në kërkesa të pronarëve të këtyre parcelave, por të cilët janë edhe afaristë të suksesshëm, por edhe investime që do të bëhen në këto zona janë interes i Komunës dhe qytetarëve. Ne mendojmë se plotësimet e destinimeve të hapësirave në afarizëm banesore dhe të ngjashme nuk e dëmtojnë tërësinë e planit rregullues urban. Ndihmojnë në zbutjen e ndërtimeve pa leje, nuk dëmtojnë në imazhin e kësaj pjese dhe ndihmojnë në rritjen e të hyrave vetanake, por me rëndësi është se edhe ndihmohen investitorët privat.

Ky propozim në Komitetin për Planifikim iu ka dhënë pëlqimi këtij rekomandimi dhe ka kaluar në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Ejup Haziri- ne si grup i PDK-së i kemi marrë informatat me kohë, prandaj ne jo që jemi vetëm për pikën e dytë, por të 3, 4 dhe 5 janë të sqaruara dhe propozoj që t’i kompensojmë ato hapësirat të cilat i humbëm sot.

Ramiz Ramadani- unë dëshiroj ra rikonfirmoj edhe njëherë qëndrimin e LDK-së të cilin e kemi pasur edhe në komitet, për ta kundërshtuar këtë ndryshim, sepse nuk kemi bazë ligjore. Plotësimi për këtë ndryshim është mbështet në 4 nene, në nenin 15, të cilin jam i detyruar për ta lexuar pika 2. ku thotë:” secila komunë do t’ shqyrtojë dhe nëse paraqitet nevoja do t’ i ndryshojë planet rregullative” Sipas meje nëse thirremi në këtë çdo gjë është e qartë, neni 16, pika b, nuk e rregullojnë këtë fushë dhe nuk e kam të qartë kush i ka inkorporuar këto dy nene?

Neni 20 thotë: “ ndryshimet dhe plotësimet e planeve hapësinore dhe urbanistike, bëhen sipas mënyrës dhe procedurës të përcaktuar për miratimin e tyre fillestar”

Nga kjo çdo gjë është e qartë dhe tash më duhet për ta kundërshtuar drejtoreshën, sepse ka qenë një kërkesë para këtyre që kanë arrit tash, por drejtoresha decidivisht e ka kundërshtuar atë kërkesë me arsyetim se: në atë zonë ekziston plani rregullativ dhe nuk lejohen ndërhyrje dhe tek pas pesë viteve lejohen. Si komitet unanimisht e kemi mbështet dhe përkrah. Mirëpo tash dua ta di pse lejohet kjo ndërhyrje? Për mua çdo lejim i ndërhyrjes i bie një përgjegjësi edhe Këshillit të Ekspertëve edhe komitetit dhe mbi të gjitha Drejtorisë së Urbanizmit.

Unë mendoj se nëse veprojmë kështu së pari duhet ta anulojmë vendimin e mëparshëm, pastaj ta aprovojmë këtë propozim, sepse kështu nuk ka asnjë bazë për ndërhyrje.

Bahrie Mamuti- lidhur me atë që z. Ramadani e thotë se në seancën e kaluar është kundërshtuar, unë këtë kundërshtim e kam bërë, sepse ajo ka qenë një kërkesë individuale dhe për këtë edhe nuk e kam parë të arsyeshme të bëhen ndërhyrje. Mirëpo në vazhdimësi kërkesat janë shtuar dhe janë parë mundësitë që në atë hapësirë ka kërkesa që e rrisin potencialin e zhvillimit të asaj zone.

Mirëpo te nenin 20, te Ligji i planifikimit hapësinore, na e jep mundësinë për të bërë ndryshime, por vetëm duhet të kthehemi në fazën fillestare dhe duhet kaluar procedurat përmes Kuvendit.

Ramiz Ramadani- pikërisht është ashtu si e tha drejtoresha, por ku është dallimi në mes të një kërkesë individuale dhe në mes 3, por le të jenë edhe 30? Ne jemi të detyruar për ta zbatua ligjin si për 1 kërkesë si për 30.

Floronë Zymberi- unë mendoj se parimisht duhet të kemi kujdes në ruajtjen e këtyre kërkesave dhe vlerave, ruajtjen e rregullativave ligjore, ruajtjen e të drejtës së autorësisë dhe ne nuk guxojmë të ikim shumë nga plani i mëparshëm, por do të kemi vetëm disa plotësime. Nuk do të humbet identiteti dhe të ndryshohet plotësisht, ajo çka është aprovuar në asamblenë komunale. Me disa plotësime duke e ruajtur konceptin arkitektonik, ruajtjen e destinimit dhe shfrytëzimit të sipërfaqeve, ruajtjen e infrastrukturës rrugore, të ujit, kanalizimit, ruajtjen e përputhshmërisë me planin zhvillimor dhe ruajtjen e vlerave arkitektonike për këtë pjesë.

Substanca duhet të ruhet, por duhet bërë disa plotësime, sepse janë rritur kërkesat e qytetarëve, prandaj njerëzit duhet mundësuar që të punojnë dhe të mos ia mbyllim rrugët.

Arben Mehmeti- unë kam vetëm një pyetje për drejtoreshën. Këto vendime të na konfirmojë decidivisht drejtoresha, këto vendime a janë apo nuk janë në kundërshtim me ligjin? Këtë pyetje e kam, drejtoresha të përgjigjet shkurt dhe të shënohet në procesverbal saktë?

Bahrie Mahmuti- ne mendojmë se nuk janë në kundërshtim me ligjin, sepse te neni 20, mbi Ligjin për planifikim hapësinor e lejohet plotësimi i Planit zhvillimor urban.

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesi i Kuvendit, propozon që të aprovohet pika 2 e rendit të punës.

Aprovohet pika 2 e rendit të punës: Propozim-vendimi për qasjen e plotësimit të Planit rregullues urban “Fidanishte” me 17 vota për, 9 kundër dhe 5 abstenime

3. Propozim vendimi për qasjen e hartimit të Planit Rregullues Urban: “Livadhet e Arapit

Bahrie Mahmuti- edhe për këtë propozim-vendim, arsyetimin e dha drejtoresha e urbanizmit të cilin arsyetim, anëtarët e Kuvendit e kanë me shkrim në materialin e seancës

Florinë Zymberi- unë mendoj se sa më shumë që të kemi plane rregullative, aq më tepër do të kontribuojmë në rritjen e vlerave urbanistike dhe arkitektonike në Komunë.

Duhet ta ndajmë edhe kafshatën e gojës për hartim të planeve të tilla dhe të punojmë në atë drejtim që t’ ndalim ndërtimet pa leje. Mirëpo është çështje e buxheti të Komunës, sepse ka qenë desh që i tërë qyteti i Gjilanit t’ i ketë këto plane.

Arben Mehmeti- e kam një rekomandim për kryetaren e komitetit e cila duhet të rezervohet nga diskutime që i legalizojnë shkeljet ligjore me qëllim të mbrojtjes së interesave të afaristëve. Ne jemi në Kuvend në radhë të parë që ta mbrojmë zbatimin e ligjit dhe më vonë të bizneseve. Mirëpo e kam edhe një kërkesë teknike për administratën që ky toponim “Livadhet e Arapit “ të ndryshohet, por edhe disa toponime tjera që po na dalin në dokumentet kadastrale.

Ramiz Ramadani- po theksoj se ne e mbështesim këtë propozim dhe hartimin e çdo plani që e rregullon harmonizimin e një gjendje ekzistuese me gjendje e planifikuar, në parim e mbështesim, por kërkoj nga drejtoresha që të jetë në nivel dhe të mos lejojë shkelje nëse vërtetë ka dhe t’ i kushtojmë kujdes debateve me qytetarë dhe mos të vijmë në atë gjendje që ishim më herët.

Sokol Haziri- meqenëse u pa më herët se planet rregullative janë bërë, por nuk janë bërë në konsultim me komitetin e biznesit dhe pjesën dërmuese të tyre, kësaj radhe do të ishte mirë që të konsultohet mirë dhe shumë mirë qoftë biznesi, qoftë shoqëria, në mënyrë që më vonë mos të thuhet se po shkelet ligji, sepse ligji është mbi të gjithë edhe mbi biznesi dhe mbi neve dhe atë duhet respektuar.

Nuk pati debatues të tjerë përkitazi me këtë pikë dhe kryesuesi kërkon nga kuvendarët që të aprovohet

Aprovohet me vota unanime të anëtarëve të kuvendit pika 3 e rendit të punës: Propozim-vendimi për qasjen e hartimit të Planit rregullues urban “Livadhet e Arapit”

4. Propozim vendimi për anulimin e pjesërishtëm të vendimit të KK-së 01.Nr.7840 të datës 14.07.2009,

Izmi Zeka- kjo çështje ka kaluar në Komitetin për Politikë dhe Financa, por për sqarim më detal fjalën do ta ketë drejtori i Arsimit.

Bujar Nevzadi- këtu është fjala për katër hektarë e 27 ari e 24 m, të cilin vendim e kemi marrë 14.7.2009, në kohën kur AKP, pat marrë vendim për ta shitur këtë tokë. Ne patëm shikuar mundësinë për ta ruajtur, por kjo punë është e përfunduar, prandaj sot duhet të merret një vendim që kjo të rikthehet, sepse kjo punë ka marrë fund, AKP e ka shitur tokën, kurse pronari e ka blerë. Ne duhet ta zgjidhim këtë çështje, sepse “Danida” daneze kërkon që mos të kemi probleme. Ne e kemi bërë një marrëveshje për ndërtimin e Shkollës Bujqësore dhe kërkoj nga ju që ta votoni dhe mbështetni këtë propozim

Sadudin Berisha- ne e dimë se edhe në periudha të caktuar, por edhe sot kemi telashe të kësaj natyre kemi qeveri mbi qeveri, por Kuvendi i Komunës e ka nxjerr një vendim për interes të qytetarëve të Komunës dhe për një dedikim të caktuar, por paraprakisht ka qenë desh që të shoshitet çdo mundësi për hapësirë ligjore për ta legalizuar dhe për ta kthyer në librat Kadastral si tokë e Komunës. Formulimi i vendimit nuk ka asnjë lloj ndikimi, sepse vet vendimi kur është marrë nuk është mbi baza të ligjit në fuqi dhe mbi baza të asaj që e thash më parë. E ka marrë një vendim duke menduar se do të has në mirëkuptim dhe do të mund të legalizohet si pronë e KK-së pas marrëveshjeve që do të bënte me AKP-në.

Tash ndryshimi i vendimit nuk ka efekt juridik, sepse është një akt i cili është i plotfuqishëm dhe nuk është ndikues. Si do që të jetë ne mund ta shfuqizojmë.

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesi e propozon për aprovim këtë propozim- vendim.

Aprovohet me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit pika e 4 e rendit të punës:
Propozim vendimi për anulimin e pjesërishtëm të vendimit të KK-së 01.Nr.7840 të datës 14.07.2009

5. Lista e projekteve prioritare për vitin 2011,

Fadil Osmani- unë përmes adresave elektronike disa anëtarëve të Kuvendit ia kam paraqitur edhe atë e kam paraqitur në bazë të gjendjes momentale. Në faqen e parë janë 20 projekte të cilat janë kontraktuar në vitin 2009 dhe kanë kaluar në vitin 2010 dhe mendojmë që deri në fund të majit, eventualisht nga mesi i korrikut do të përfundojnë.

Është pjesa e dytë gjegjësisht lista e projekteve të cilat i kemi publikuar dhe janë në vlerësim, prej të cilave disa janë të shpallura e cila është listë prej 23 projekteve, të cilat projekte krijojnë infrastrukturë të mirë për Komunën e Gjilanit.

Ka edhe disa projekte me disa OJQ, me të cilat Zyra e projekteve bashkëpunon, si është USAID-i amerikan, Komisioni Evropian etj.

Me disa projekte jemi partner me disa organizata lokale dhe ju e dini se Komuna e Gjilanit e ka shpallur edhe tenderin për ndërtimin e Bibliotekës Rajonale dhe i inkurajoj kompanitë private që të konkurrojnë në këtë projekt.

Me TIK-ën Turke, po realizohen dy projekte janë në përfundim punimet e vrazhda të Medresesë “Alaudin” dhe është i kontraktuar rregullimi i shtratit të lumit në Dobërqqan.

Me CDI-në jemi duke i realizuar disa projekte për të cilat e keni listën.

Në parim kemi lidhur kontratë edhe për realizimin e dy projekteve e të cilat janë në fshatin Bresalc dhe Ponesh, do të thotë rregullimi i rrjetit të ujësjellësit dhe fshati Pogragjë ku do të rregullohet rrejt i kanalizimit së bashku me impiantin apo objektin ku do të trajtohen edhe ujërat e zeza. Po ashtu kemi projekte me GTZ-në, UNHCR-in dhe disa OJQ të tjera.

Në vijim të falsë së tij z. Osmani i përmendi edhe disa projekte të tjera të cilat anëtarët e Kuvendit i kanë së bashku me materialin tjetër për seancë.

Arben Mehmeti-unë e përshëndes këtë informatë të Zyrës së projekteve e cila është ofruar në mënyrë detale dhe është mirë që kështu të praktikohet edhe prej drejtorive dhe sektorëve të tjerë. Mirëpo edhe një vlerë pozitive ishte se këto informata na janë dërguar edhe në adresë elektronike dhe kështu ne kemi pasur mundësi për t' i parë vërejtjet. Ne në parim jemi që Zyra e projekteve të jetë më komunikative me grupet politike në Kuvend dhe të na informojë për çdo projekt që ndodh në Komunën e Gjilanit. Grupet politike duhet të informohen së paku përmes një imele, shkrese zyrtare me qëllim që edhe ne të kemi njohuri të mjaftueshme përkitazi me atë se çka po ndodh në Komunën e Gjilanit. Pavarësisht se ne jemi opozitë, ne duhet të informohemi dhe të japim një kontribut pozitiv në këto aspekte. Nga projektet që unë i kam parë kam vërejtur se ka projekte për zgjerim të rrugëve për Ferizaj, Bujanoc, Prishtinë, por mungon projekti për zgjerim të rrugës për Preshevë, në drejtim të lagjes "Arbëria".

Unë propozoj që kjo rrugë të jetë pjesë e agjendës së Zyrës së projekteve, sepse është një segment mjaft i rëndësishëm që lidh Kosovën me Kosovën Lindore dhe duhet pasur një fokusim më të mirë në drejtim të Preshevës.

Tjetër është se unë e kam vërejtur një qarkullim në lagjen "Arbëria" deri në Shkollën "Abaz Ajeti", sepse aty është një problem i madh, sepse aty udhëtojnë nxënësit dhe deri tash nuk ka ndodhur ndonjë fatkeqësi, është mirë që Zyra e projekteve ta marrin edhe këtë projekt dhe ta parashikojnë një trotuar, sepse kështu i kontribuojmë mbrojtjes së interesit të nxënësve. Këto gjëra Zyra e projekteve t' i ketë parasysh, sepse ne do të kërkojmë përsëri llogari për këto gjëra.

Gjithashtu tek parashikimi i projekteve, asfaltimi i rrugëve etj duhet të ketë konsulta me zyrtarë të zgjedhur të këtij populli, sepse të gjithë ata që janë ulur në këto karrige e kanë një mandat dhe obligim për t' i shprehur brengat dhe të vendosin për dike. Unë po e them se ne grupi i LDK-së, nuk kemi pasur konsulta në këtë drejtim për ta dhënë një kontribut pozitiv, mirëpo lista e profiteve përpilohet nga zyrtarët e PDK-së e cila gjë nuk duhet të ndodh kështu. Duhet ndal këtë trend negativ, prandaj duhet të epet shembull pozitiv sidomos nga kryesuesi i Kuvendit. Kjo po ndodh se listat i përcakton PDK-ja se cila rrugë duhet asfaltuar ose meremetuar dhe ka raste aty ku ka më shumë pjesëtarë të LDK-së, ato rrugë lehen anash. Unë jam për t' u ndërprerë kjo dhe të vazhdohet në mënyrë më të mirë, kurse te mbikëqyrja ajo po bëhet në mënyrë jo profesionale dhe për këtë po kemi dështime. Edhe një gjë duhet theksuar që ne sa herë që bëjmë ndonjë shkresë në Zyrën e projekteve, së paku menaxheri i kësaj zyre të na kthejë përgjigje se kjo nuk mund të realizohet me qëllim që ne ta kemi një dëshmi që një propozim i yni nuk është realizuar.

Arben Maliqi- edhe ne në emër të grupit e të AKR-së e përshëndesim punën e shefit të Zyrës së projekteve, mirëpo unë nuk pajtohem me atë, sepse në dy takime të cilat i kemi pasur nuk kam marrë asnjë informatë, prandaj kërkojmë që edhe ne t' i kemi këto informata. Sa i përket kësaj liste kur njeriu i sheh në letër janë për mrekulli, por duhet ta

dini se në praktikë asnjë punë nuk është bërë ashtu si duhet të bëhet. Është ndërtuar një shkollë për mrekulli në Zhegër, mirëpo rruga është e tëra me baltë, nuk ka sallë dhe i mungojnë shumë gjëra të tjera. Unë pajtohem me parafolësin i cili i përmendi shumë gjëra dhe duhet të kemi kujdes kush është organ mbikëqyrës dhe kush është në pranim teknik të objekteve? Në fshatin Kosaq, është bërë një pranim teknik i ujësjellësit, por aty ka shumë parregullsi, nuk as rrëzë, nuk ka shirit, kjo është një vërejtje e madhe.

Do ta pyes Fadilin se çka po ndodh me ndërtesën e Stacionit policor? Unë i kam disa informata pse është ndërprerë puna. Por unë e kam edhe një çështje, e ajo është për Lagjen “Dardania” ku dihet se Drejtoria e Shërbimeve e Publike, në bashkëpunim me Inspeksionin kanë bërë një punë të madhe në këtë lagje, sepse është bërë kufizimi i hapësirave për kafiteri deri ku mund të shpërndajnë karrige dhe janë ngarkuar me tatime të cilat janë të obliguara. Por pasi po kërkojnë të paguhen tatimet, unë mendoj se duhet të projektohen edhe trotualet në lagjen “Dardania I”, sepse është lagje e cila i kryen obligimet shumë në rregull.

Jakup Bajrami- unë nga lista e projekteve në faqen e parë po i shoh disa projekte të cilat kanë filluar në vitin 2009, por të cilat janë në përfundim e sipër, por edhe në faqen e dytë tek projekti nr. 17 dhe 21, nga të cilat njëri projekt parasheh ndriçimin e qytetit dhe fshatrave, kurse tjetri për asfaltim të rrugëve. Unë mendoj se projektuesi duhet të na jep shënimet e sakta se për cilat rrugë është paraparë ky asfaltim?

Unë e kam fjalën për rrugën afër “Kodrës së Dëshmorëve” dhe fjala është për ndriçimin e rrugës kryesore e që e lidhet me rrugën qarkore e cila është e vetmja rrugë në të cilën nuk ka përfunduar ndriçimi komplet. Unë propozoj që kjo lagje të ndriçohet e cila i ka vetëm 200-300 m, kjo është kërkesë e lagjes dhe dua ta di se kur do të kryhet ky projekt pasi që më është thënë nga Drejtori e Shërbimeve Publike se është në prioritet?

E njëjta gjë është edhe me asfaltimin e rrugëve tek “Kodra e Dëshmorëve”, në të cilin vend janë bërë disa riparime vitin e kaluar, por edhe këtu dua ta di se cilat rrugë janë paraparë, sepse janë disa rrugë të mbyllura dhe duhet ditur se a janë paraparë ato rrugica të cilat kanë mbetur vitin e kaluar për pa u asfaltuar?

Rruga për Kravaricë është paraparë me një vlerë prej 22 mijë euro, kjo është vetëm një minimum, sepse e tërë ajo rrugë me siguri ka një kosto prej 500 mijë euro.

Sokol Haziri- jam plotësisht koshient, se politikën në Komunë e zbaton partia e cila i ka fituar zgjedhjet dhe dëshiroj që suksesshëm të zbatohet kjo politikë. Mirëpo kërkoj që punët dhe projektet të cilat zbatohen të jenë të kualitetit të lartë dhe me standarde të dëshirueshme. Mua më vjen keq kur i shoh disa projekte të cilat një mjeshtër i thjeshtë do t’i kishte bërë më mirë. Nuk dua vetëm të kritikoj, por dua të them se mjetet e taksapaguesve po harxhohen, por punët të kryhen me cilësi të lartë në mënyrë që mos të kemi nevojë të intervenojmë menjëherë.

E dyta ka pjesë në qytetin e Gjilanit që nuk ia ka shtrirë dorën asnjë pushtet prej pas luftës, ka objekte dhe shtëpi të ndërtuar shumë bukur të cilat janë të rralla në qytetin e Gjilanit, kurse pushteti nuk e ka bërë asnjë hap në rregullim të infrastrukturës. E tillë është rruga “Shyt Mareci”, I dhe II. dhe e lus Zyrën e projekteve që të bëjë diçka në këtë drejtim.

Kërkesë e imja themelore është që zhvillimi të jetë jo vetëm numerikisht, por edhe të jetë shumë kualitativ.

Elisah Ymeri – në emër të grupit parlamentar të PDK-së e falënderojmë shefin e Zyrës së projekteve z. Fadil Osmanin për punën e madhe që po e bën dhe lirisht mund të themi se pa një kontribut të tillë nuk do të i kishim arrit këto rezultate, si me projekte dhe me investime, por megjithatë nuk jemi edhe për t’ u lavdëruar.

Kemi edhe mjaft kritika dhe shumë gjëra për t’ u thënë, por unë dëshiroj që Zyra e projekteve të ketë një prioritet të veçantë për disa rrugë, sepse nuk është njësoj sikur të ndriçohet rruga në një fshat dhe rruga afër një shkolle!

Unë personalisht kam vërejtje tek lagjja “Arbëria”, mirëpo ne jemi pajtuar me Fadilin që të bëjmë një zgjerim të rrugës prej Kombinatit të Duhanit deri tek përfundimi i rrugës së Preshevës, sepse aty ka rrezik për nxënësit, prandaj si prioritet duhet të jetë zgjerimi dhe ndriçimi i rrugës, kjo ka ngec.

Kërkoj ta di ku qëndron problemi dhe pse nuk është bërë një projekt i tillë?

Si çështje tjetër dua ta di atë problemin e kanalizimit në lagjen “Arbëria” pse nuk është rregulluar? Kjo është një iniciativë qytetare e cila i ka 1.5 vjet? Kjo pjesë e qyteti është në gjendje të rëndë sa i përket kanalizimit.

Unë kërkoj që ta di se kur do të bëhet projekti për këtë lagje?

Mandej dua ta di se ku ka mbet projekti për lagjen “Arbëria” mbi rrugën e Preshevës?

Mandej duhet të ketë një prioritet më të mirë për këto gjëra dhe një sqarim për këto pyetje që i bëra.

Ibrahim Neziri- lista që është hartuar po quhet prioritare. Më intereson ta di se cila është mënyra për ta bërë një projekt prioritar? Edhe unë po e jap një shqetësim për lagjen “Dheu i Bardhë”, sepse në këtë lagje qytetarët me vite dërgojnë kërkesa për asfaltim, por nuk ka asgjë nga ato kërkesa dhe nuk ka përgjigje me vite!

Një pjesë është afër qendrës, afër shkollave të mesme, rrugë të cilën e njoh që mbi 30 vjet dhe aty jo që nuk është e asfaltuar, por aty qytetarët janë edhe të rrezikuar. Një e reshur sado e vogël ato shtëpi vërshohen nga uji!

Kjo pjesë nuk dot ë thotë që të jetë vetëm e asfaltuar, por duhet pasur një kanalizim për ta eliminuar rrezikun nga vërshimet! Këtu janë kritere për ta pasur një prioritet kjo pjesë.

Nevzad Rushiti- nga lista e projekteve po shihet se është bërë një punë e mirë, sepse po shihet se çka është punuar, çka ka ngec dhe çka është duke u punuar. Në këtë sallë të KK-së ne i kemi tre këshilltarë komunal nga “Dheu i Bardhë”. Në këtë lagje është punuar shumë pak pas lufte edhe pse është lagjja më e vjetër, por e lënë pas dore edhe gjatë kohës së komunizmit. Kjo është arsyeja se në këtë lagje ka nevojë për investime mjaft të mëdha, investime të cilat janë prioritet për banorët dhe lëvizjen e tyre.

Në këtë lagje është një rrugë e cila del në rrugën qarkore në gjatësi prej mbi 200 m e cila rrugë është në gjendje shumë të keqe, prandaj si pushtet ka mundësi për ta zgjidhur, sepse ka gjatësi prej 250 m. Në seancën e mëparshme ai qytetari Tahir Borovci këtu foli në emër të qyfterëve të lagjes së vet, por unë Zijadin dhe Sokoli i dimë që aty janë disa rrugica të shkurtra dhe të ngushta, që për komunën tonë janë harxhime të vogla për ta zgjidh atë problem të atyre qytetarëve. Mandej është rruga tjetër afër poligonit e cila së paku i lidh 200 shtëpi e cila është e pa asfaltuar, mandej është rruga “Rukije Haliti” në të cilën rrugë kanalizimin e kanë bërë vet qytetarët qysh para luftës, por investime të tjera nga Komuna nuk ka pasur. Pjesa te Banja, që dy vite kanë mbetur dy rrugë për pa u përfunduar për shkak të dy personave të cilët kanë ndërhyrë aty. Ky pushte nuk ka pasur mundësi ta zgjidh këtë problem në këtë pjesë me ndonjë marrëveshje, apo kompensim?

Ajo pjesë ka mbet shkretë, anësorët janë skajeve të rrugës.

Sa i përket ndriçimit publik, unë që dy vite e përcjell gjendjen dhe aty vetëm 10% punojnë llampat elektrike, kurse 90% është errësirë.

Tek trotuare ka filluar diçka të bëhet, por rruga e cila para 30 vite është menduar që të jetë qarkore e cila edhe sot është si qendër e “Dheut të Bardhë” së cilës ka nevojë t’i bëhet trotuare, sepse ka një gjerësi prej 5 m.

Tek “Kodra e Dëshmorëve”, pjesa e djathtë disa rrugë, nuk furnizohen me ujë gjatë tërë ditës, sepse kanë pengesa, por edhe ky problem do të kishte mundësi të zgjidhet me një investim shumë të vogël.

Mua më vjen keq, por në lagjen e “Dheu i Bardhë” nuk po shoh asnjë cent investim.

Sokol Haziri- ishte kënaqësi për ta dëgjuar Nevzadin se çka tha, sepse brenga të tilla ka plotë në qytet, por mua po më intereson se kujt po i flasim ne a është ndokush që po mban ndonjë evidencë apo procesverbal dhe çka po ndodh këtu?

Kisha desh që të keni konsideratë në këto çështje dhe të keni kujdes?

Zijadin Maliqi- unë për këto çështje po ia jap një vërejtje shëfave të grupeve, të cilët janë dhe në Komitet për Politikë dhe Financa dhe në takime të shëfave dhe përsëri flasin këtu për çështje të lagjeve të veta. Këto çështje janë tonat e jo të shëfave, sepse ata flasin kur është fjala për gjëra të përgjithshme.

Unë i analizova edhe projektet dhe si vërejte e imja është se disa projekte të caktuar po zgjasin shumë edhe ato me vlera të vogla, por zgjasin edhe dy- e tri vjet. U dhanë edhe vërejtje rreth pranimi teknik dhe mbikëqyrjes të cilat i kam thënë edhe unë disa herë, por tash e vërejte se në vitin 2011 janë zgjedh edhe ndërmarrje të cilat do ta bëjnë mbikëqyrje dhe revidimin e projekteve e cila gjë është për lëvdatë.

I analizova bukur shumë, këto projekte, e dëgjuam edhe Sokolin dhe Nevzadin, por ne më shumë po flasim për anët tona, por duhet të flasim edhe për gjërat tjera në përgjithësi. Mendoj se ka mjaft për t’u bërë dhe është e pamundur brenda një apo dy vite të përfundojnë të gjitha. I përmend disa rrugë dhe rrugica Nevzadi, për të cilat e kam pasur në mend të flas, por nuk po i përsëris, por si prioritet të cilin e kam thënë edhe më parë është ajo Shkolla Fillore “Rexhep Elmazi” duhet ta ketë një sallë të edukatës fizike. Kjo vërejte është dhënë, është hyrë në prioritet, por u bënë që tri vite dhe ky projekt është harruar!

Tjetër është rruga qendrore e lagjes që shkon në shkollë e cila është pa trotuare dhe ka mundësi të bëhen trotuare, sepse nxënësit shkojnë në shkollë përmes rrugës.

Unë të tjerat nuk po i përmendi, sepse u thanë nga kolegët, por po theksoj se janë dy-tri rrugë shumë të shkurtra të cila bien në rrugën kryesore dhe me rastin e të reshurave e tërë balta bie në rrugën kryesore dhe për këto rrugë është një investim mjaft i vogël.

Izmi Zeka- ne tash e kemi rishikimin e buxhetit dhe para se ta bëjmë rishikimin e buxhetit ne do ta bëjmë edhe rishikimin e projekteve në këtë gjashtë mujor. Me shëfat e grupeve e bëjmë një rishikim pastaj e sjellim në KK-.

Nuk kisha dëshiruar që të përqendrohemi secili në pjesët ku jeton. Qyteti është i të gjithëve. Ne po merremi vesh kështu dhe po e thërrasim edhe shëfin e Zyrës së projekteve për t’u marrë vesh se cilat projekte po i përfshijmë.

Shukrie Rapuca- mua më vjen keq që e mora fjalën lidhur me atë epitetin që secili të fasë për rrugën ose lagjen e vet. Mirëpo unë kam të drejtë të them diçka në këtë aspekt,

sepse punoj në lagjen “Arbëria”, kurse vij nga lagja “Zabeli i Sahit Agës” dhe i vërej mirë nxënësit e dy lagjeve se si udhëtojnë?

Në lagjen “Zabeli i Sahit Agës”, kam punuar e cila është shkollë e re e cila i plotëson të gjitha kushte me përjashtim të sallës së edukatës fizike e cila mungon si në lagjen “Arbëria” Mirëpo aty është një problem, sepse nxënësit vijnë nga rrugët e ndryshme të “Zabelit të Sahit Agës”, por duhet ta dini se që 4 vjet bëjmë kërkesë si qytetarë të Zabelit dhe asnjëherë nuk është marrë parasysh kërkesa jonë. Nxënësit nga rrugët e ndryshme vijnë me baltë dhe kur hyjnë në shkollë aty paraqiten probleme të shumta, sepse në mes të arsimtarëve çdo ditë ka probleme, sepse bëhen ofendime se gjëja Zabeli nuk është i edukuar, janë me baltë dhe nuk i kanë parasysh rrugët nga të cilat vijnë? Kështu disa nxënës të cilët janë të detyruar që në shkollë të vijnë me dy e tri palë ndërresa(mbathje). Personalisht unë i kam vërejt këto gjëra dhe ka ndodh që nxënësit kanë marrë ndonjë qortim nga arsimtarët, por këtë duhet shqyrtuar, sepse asnjë rrugë nuk është ashtu si duhet. Unë e pashë në listën e projekteve se është një shumë diku rreth 300 mijë euro për asfaltim të rrugëve, por nuk jam në dijeni se për cilat rrugë është fjala, por e di se disa ditë pak para zgjedhjeve një rrugicë është asfaltuar e cila rrugicë nuk ka më shumë se dy-tri familje, kurse asfalt nuk kam parë me vite të tëra në “Zabelin e Sahit Agës”

Bahrie Veseli- unë e shfrytëzoj rastin ta falënderoj Zyrtarin për projekte për një informatë shumë të qartë dhe të kuptueshme, mirëpo edhe pse secili paraqiti kërkesa për rrugët dhe lagjet e veta ku jetojnë, unë po bëj një apel që të gjithë qytetarët e Gjilanit të trajtohen njëjtë. Këtë po them se ka lagje në të cilën të gjitha ndërtimet i janë bërë pa leje, kurse në anën tjetër i kanë rrugët e asfaltuara.

Ne nuk jemi kundër kësaj, por duhet të ketë kritere për asfaltim të rrugëve. Konkretisht në rrugën ku jetoj unë dhe anëtari tjetër i Kuvendit z. Elisau është e një rrugë e urbanizuar, por ende është e pa asfaltuar. Ka pasur presione nga më të ndryshme nga qytetarët të cilët edhe kanë reaguar për atë, sepse po asfaltohen rrugët më të largëta, kurse kjo pjesë anashkalohet! Unë apeloj te zyrtari për projekte që kjo rrugë të hyjë në prioritet dhe të mos anashkalohet sipas asaj ku jetojnë shefat e grupeve politike dhe sipas lidhjeve familjare.

Unë kam edhe një shqetësim tjetër, sepse e pash në prioritet ishte ndërtimi i një trafoje në lagjen “Arbëria” e cila iu ka premtuar shumë herë qytetarëve e sidomos para zgjedhjeve, prandaj kërkojmë që ky projekt të përfundojë sa më parë, sepse në atë lagjeje ka pasur dhe ka ende shumë probleme me furnizim me energji elektrike.

Një shqetësim tjetër është për lagjen e Tetë, tek një rrugë e mbyllur të ketë kujdes zyrtari që ajo rrugë të mos mbesin ashtu, por të hapet për nxënës dhe arsimtarë.

Elisah Ymeri- rastin e trafo të cilën e përmendi zonja Bahrie, dikush në emër të lagjes për blerje të vendit (tokës) ku dot ë vendoset trafoja. Unë kërkoj falje nëse nuk është ashtu, por më gjasë ai person është i partisë së zonjës Bahrie i cili ka mbledh mjete për vendin e trafos, por vendi është caktuar dhe punët po kryhen, prandaj duhet pasur parasysh.

Jashar Jashari- z. Jashari para anëtarëve të Kuvendit, dha disa vërejte lidhur me disa projekte të cilat po përfundojnë, por me një cilësi shumë të dobët e të cilat projekte po paraqitet nevoja pas një kohe shumë të shkurtër për të ndërhyrë.

Mandej si vërejtje tjetër pati edhe atë se në rrugën e tij “Agush Haziri” në dalje të Prishtinës nuk është investuar asgjë, por gjatë falës së tij dr. Jashari pati edhe disa vërejtje të tjera, të cilat i dorëzoi me shkrim në sekretari të cilat do të jenë pjesë e procesverbalit.

Bahrie Veseli- mua më intereson për ta ditur se kush është ai person i cili ka grumbulluar të holla në emër të grupit të LDK-së? Të thuhet me emër dhe mbiemër, sepse unë nuk e posedoj këtë informatë! Këtu është vendi për sqarim?

Ibish Ibishi- unë së pari po filloj prej investimeve të cilat kanë filluar në vitin 2009 e të cilat nuk kanë qenë fare në planifikim dhe kanë vazhduar në vitin 2010, por ndoshta edhe në vitin 2011. Kjo është arsyeja që nga njëherë edhe po i ngatërrojmë planifikimet e kompletuara të cilat po i bëjmë.

Unë po theksoj se në të ardhmen duhet të kemi një kujdes më të veçantë në këto planifikime.

Unë së pari po ndërlidhem me projektin nr. 13 ku thuhet: konservimi dhe restaurimi i “Sahat kullës” në Gjilan e cila shumë është mbi 41 mijë euro. Kurse në kontratë thuhet rregullimi, ndërtimi i “Sahat kullës” në Gjilan thuhet është shuma 80 mijë euro.

Një sqarim nëse ka mundësi a është rregullim apo restaurim?

Vërejtje tjetër është në fshatin tim ose në rrethinë të fshatit tim, ku e kemi pasur një urë e cila e lidh fshatin Dobërçan me fshatrat e Kosovës Lindore dhe fshatrat Stublinë, Pogradjë. Ai projekt vit pas viti është anashkaluar dhe deri më sot ka mbet i pa zbatuar dhe nuk e kam të qartë a është diku edhe në letër? Kërkesat janë bërë vazhdimisht, por nuk e kam të qartë se çka ka ndodhur me ato kërkesa?

Mirëpo tek buxheti i kryetarit ndahen 120 mijë euro për ndërtimin e urave, por në listën e projekteve nuk e shoh as një urë e cila ka nevojë për ndërtim?

Unë e lus z. Fadilin i cili e përfaqëson zyrën e projekteve që t’ i ketë parasysht këto vërejtje dhe t’ i fusin në prioritet këto gjëra që i thash.

Kam pyetje për Fadilin për dy çështje për investime publike dhe njëra është lidhur me instalimin e rrjetit kryesor të ujësjellësit në fshatin Mireshe 54 mijë e 500 euro, për të cilin rast e di që është bërë një kontratë e tillë, por në terren nuk është bërë asnjë punë!

Kërkoj përgjigje çka është duke ndodhur?

Tjetra është për asfaltim të rrugëve e njëjta pyetje,

Kam një vërejtje për një rrugë në qytet të cilën nuk e përmendi askush e kjo është rruga në udhëkryq, rruga e tregut në të cilin vend kemi mjaft operator të cilët i kontribuojnë qytetit, por edhe tregu në përgjithësi është kontribut dhënës, kështu që unë propozoj që të jetë në prioritet, sepse ai vlen pasi që është rrugë me rëndësi.

Unë mendoj se qeveria komunale duhet të bëjë trysni që sa i përket buxhetit të trajtohem i të gjithë të barabartë si qytetarët e tjerë të Kosovës.

Ramiz Ramadani- propozime të cilat i kam për lokalitetin prej nga vij do t’ i përcjelli shefit të grupit parlamentar, por e kam një propozim të cilin patjetër duhet t’ i bëj Zyrës së projekteve, mendoj se është rrjeti i ujësjellësit në fshatin Nasalë. Të gjithë e dinë se banorët e këtij fshati konsumojnë ujë mineral të pa përpunuar e që unë jam i bindur që ai ujë është mjaft i dyshimtë për pije dhe ne si njerëz që jemi të obliguar për ta ruajtur shëndetin publik, ai projekt ka qenë desh të jetë i pari në prioritet. Po theksoj se këtë duhet ta keni në konsideratë!

Pjesa e dytë e shqetësimit tim është ndarje buxhetore për tri vitet e ardhshme. Këtu nuk është drejtori i Bujqësisë, por as kryetari i Komunës, por unë po them atë brengën time e cila më shqetëson, sepse është një ndarje aspak serioze.

Projekti është i barabartë me mirëmbajtjen komunale për tri vitet e ardhshme ose është dyfish më i vogël, se sa mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave të gjelbëruara.

Lidhur me këtë ju duhet menduar se sa është serioz ky planifikim.

Florinë Zymberi- ne të gjuhë e dimë që në kohën e fundit kanë kaluar tri plane rregullative, por e di edhe atë se ka shumë problem për t' i zbatuar këto plane. Ne bëjmë përpjekje, por është problem të kuptohemi me qytetarë të pa ndërgjegjshëm.

Unë mendoj se së pari duhet të trasohen rrugët minimum me zhavorr, traseja nga shkojnë rrugët në harmoni me planet rregulluese në mënyrë që të jetë si udhërrëfyes që qytetarët të mos ndërtojnë pa leje. Ajo rrugë do të jetë si udhërrëfyes dhe do të ndihmojnë për zbatim të planeve rregullative.

Ejup Haziri- unë e kam një vërejtje për kryesuesin, sepse grupin e PDK-së je duke e trajtuar si opozitë, por kërkesa sot më së paku kanë pasur këshilltarët e PDK-së edhe pse është evidente se zonat ku janë të banuara me anëtarë të PDK-së më së paku janë bërë investime. Si kompromis propozoj që asfalti tash e tutje të sillet me helikopter, të gjuhet nga lartësia!

Tahir Arifi- më duket se sot e kemi huq, por kemi pasur nevojë për zbrazje dhe për ta kryer një obligim para atyre njerëzve të cilët na e kanë dhënë votën. Mua më duket se nuk është adresa te Fadil Osmani për t' i caktuar prioritetet, sepse ai është vetëm menaxher i Zyrës së projekteve. Mirëpo edhe përkundër kësaj unë i bashkëngjitëm z. Arbenit dhe zonjës Shukrie të cilët i thanë disa gjëra për lagjen “Arbëria” dhe “Zabelin” në të cilën lagjeje po kryhen disa punë po asfaltohen disa rrugë, por ka qenë një marrëveshje për t' u tenderuar shumica e rrugëve në lagjen “Arbëria”, por pastaj gabimi ka qenë tek projektuesi i cili ka kryer këtë punë, kurse ne që vijmë prej asaj pjese na sjell në pozitë shumë të keqe. Ne ka qenë desh të arsyetohemi para qytetarëve se pse shtrohet kjo rrugë e nuk shtrohet ndonjë tjetër? Dikush po e thotë se punët po bëhen në ato vende ku janë njerëzit e PDK-së, mirëpo kjo absolutisht nuk ndodh, sepse këtë e dinë të gjithë, por e din dhe Arbeni, ne jemi në një lagje, por po theksoj se rrugët nuk janë duke u asfaltuar aty ku jam unë, por besoj që do të vij rendi edhe tek unë.!

Në fund unë kërkoj nga Zyra e projekteve dhe kryetari i Komunës që pjesa e rrugëve të “Arbërisë” të cilat kanë mbet të tenderohen, pastaj së bashku me pjesën e rrugëve të “Zabelit”, sepse do të ketë një tender për këtë lagjeje, kështu ka qenë marrëveshja, prandaj unë dëshiroj ta përkujtoj shefin që kjo mos të harrohet.

Leonorë Bunjaku- unë do t' i them disa fjalë në emër timin personal, por edhe në emër të disa qytetarëve të Gjilanit. Disa gjëra u thanë, por ndoshta do t' përsëris më në detale. Së pari rruga e Tregut të Gjelbër, prej Shtëpisë së Mallrave, deri te tregu ia vlen që të bëhet një sanim ose asfaltim, sepse është rrugë shumë e frekuentuar. Ashtu është edhe rruga e II (dytë) në “Dardani” po ashtu afër rrugës kryesore tek Shkolla “Selami Hallaçi” të cilat janë rrugë në të cilat asnjëherë pas luftës nuk është bërë ndonjë intervenim.

Një çështje me rëndësi është edhe ndriçimi publik tek Konvikti dhe në përgjithësi te shkollat e mesme, sepse kam informatë se aty bëhet edhe konsumimi drogës, sepse aty

nuk ka ndriçim aspak. Kjo që e thash është aq urgjente që ndoshta sot menjëherë duhet të intervenohet dhe nuk e di pse nuk është bërë ky ndriçim deri më sot!

Sa i përket propozimit të Florës ai është me vend, mirëpo trasimi është premtuar në lagjen “Fidanishte”, por ai ende nuk ka ndodh. Kam pyetje a do të ndodh kjo më shpejtë apo jo?

Selim Selimi- unë po kërkoj vetëm një informatë nga z. Fadil Osmani, se a mund ta na jepni informoni lidhur me projektet të cilat janë paraparë nga TIKA e cila është OJQ Turke. E para është duke u realizuar ndërtimi i Medresesë, kurse e dyta rregullimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Dobërqqan. A është në fuqi kjo ende apo është ndërprerë?

Izmi Zeka- në fund po e theksoj se që nga pas lufta e këndeje nëse një pushtet nuk ka punuar sipas përkatësive partiake, jemi ne. Ju shikoni çka është punuar në Komunë e Gjilanit, aty shihen rezultatet.

Më bërë përshtypje ajo se nuk u debatuar për këto projekte të cilat janë këtu se në cilën fazë, deri ku janë realizuar?

Ne tash nuk mund të bëjmë ndryshime të mëdha, sepse tash veç ka filluar puna, por me shefat e grupeve në bashkëpunim me Zyrën e projekteve do t’i analizojmë dhe do të shohim çka do të ketë mundësi për të ndërhyrë në pjesën e dytë të këtij viti. Pas kësaj ne i sjellim në Kuvend dhe këtu i aprovojmë.

Ne mund të debatojmë, por na dalin shumë projekte për të cilat nuk ekzistojnë mundësitë financiare, por prej atyre projekteve ekzistuese ta bëjmë një zgjedhje të projekteve më të nevojshme. Mirëpo mos harroni se është punuar mjaft!

Në fund e lus z. Fadil Osmanin që nëse ka informatë shtesë t’i përcjell shefave të grupeve me shkrim. E dyta z. Fadili do të jetë me neve dhe këto gjëra së bashku do t’i propozojmë për Kuvend.

Ju falënderoj për një debat mjaft të frytshëm.

6. Informatë në lidhje me zbatimin e Planit Urbanistik në Zonën Industriale, (rruga e Bujanovcit),

Izmi Zeka- kjo pikë e rendit të punës është fut në rendin e punës me kërkesën e LDK-së, kurse fjalën për fillim dot a ketë drejtoresha e Urbanizmit.

Bahrie Mahmuti – në seancën e kaluar të Komitetit për Politikë dhe Financa e kam dhënë një informatë, por disa anëtarë të komitetit kanë kërkuar informatë analitike të cilën e kam dorëzuar të cilën e kanë marrë të gjithë.

Mirëpo ne si Urbanizëm posedojmë me një plan i cili nuk është plan rregullues urban, mirëpo i ka disa elementi të një plani të tillë. Ne punojmë sipas atij plani në të cilin gjatë procesit të planifikimit të planit zhvillimor urban e kemi inkorporuar i cili përfshin një territor diku afër 2600 m dhe ka një thellësi të zonës 150 m. Diku mbi 1110 m janë të përfshira brenda zonës urbane, kurse pjesa tjetër është pjesë e zonës së planit zhvillimor komunal. Brenda kësaj zone kemi disa pëlqime, mirëpo leje ndërtimore kemi shumë pak dhe kryesisht posedojmë vetëm me leje urbanistike. Në pjesën jashtë zonës urbane sipas gjendjes në terren janë ngrit disa objekte banesore të cilat janë jashtë zonës urbane.

Arben Mehmeti- kjo ka qenë kërkesë e LDK-së për të na informuar në këtë aspekt, por unë e kam marrë e dhe një informatë nga Drejtoria për Urbanizëm dhe kjo informatë mund të them se fare nuk i përket realitetit. Këtu konstaton Drejtoria e Urbanizmit

shkelje të planit urbanistik dhe nuk brengoset fare për masat që duhet të ndërmerren dhe për veprimet që i ka ndërmarrë drejtorja për ta parandaluar një veprim të tillë.

Unë e dëgjova drejtoreshën kur thotë kryesisht janë me leje. Kjo për mua është një lëshim shumë serioz dhe është një mungesë e ushtrimit të obligimeve nga drejtorja përkatëse.

Në shkresën që e ka dërguar për 10 objekte të cilat janë të ndërtuara pa leje dhe në këtë shkresë absolut nuk kemi asnjë veprim konkret që e lidh këtë drejtori me atë të Inspeksionit. Nuk kërkohet mbrojtje të asaj hapësire nga inspektoni. Në terren ne kemi parë se aty bëhet fjalë për 20 objekte dhe jo për 10. nga kjo shihet se nuk është informata në harmoni me atë që e kemi parë në terren. Ne mendojmë se drejtorja përkatëse ka obligim ligjor për ta respektuar planin urbanistik dhe të gjitha ato ndërtime të cilat janë në kundërshtim me planin duhet t' i rekomandojë Inspeksionit për të marrë veprime konkrete dhe para neve të vijë me dokumente konkrete për angazhim të kësaj drejtorie. Kjo kërkesë e jona nuk ka qenë sa për informatë sepse ne i kemi pasur këto, por kemi desh për ta ditur se sa është serioze Drejtorja e Urbanizmit. Nga kjo që na është ofruar neve na del një jo seriozitet flagrant e që realisht fshihet një pjesë e madhe e ndërtimeve pa leje që janë bërë në atë pjesë. Për këtë duhet dhënë llogari drejtorja dhe drejtoresha, prandaj kërkojmë që për seancën e radhës të na sillen veprimet konkrete të cila i ka bërë me qëllim të mbrojtjes së planit urbanistik në këtë pjesë. Konkretisht duam ta dimë se çka është bërë për atë plan për ta mbrojtë dhe realizuar atë plan?

Aty kërkohet për dy- tri kërkesa bëhet shkelja e planeve urbanistike dhe nuk merret për bazë shqetësimi i qytetarëve të cilët dëshirojnë që ta kenë një zonë zhvillimi në atë pjesë.

Jakup Bajrami- ne vetëm nëse e lexojmë pasuesin e fundit në informatë, menjëherë e kuptojmë se nuk është duke u zbatuar vendimi të cilin e kemi marrë në vitin 2002. Kjo çështje ka ndërlidhje edhe me Inspeksionin dhe Drejtorinë e Kadastrit dhe këtu është një gjendje kaotike, prandaj jemi për ta ndryshuar, sepse këto dy drejtori nuk kanë harmoni për ta ruajtur planin urbanistik të cilin e kemi aprovuar si një ndër planet e para.

Për këtë edhe unë i bashkëngjitëm në disa konstatime z. Arbenit dhe duhet të jenë këto drejtori me një nivel më të lartë të përgjegjësisë.

Ne për plane urbanistike po i hartojmë po bëjmë shpenzime, por nuk jemi duke i zbatuar dhe këtu ka argumente për dyshime.

Izmi zeka – nisma për këtë informatë ishte e LDK-së, por mendoj se edhe Drejtorja e Inspeksionit duhet ta shikojë dhe ta sjell një informatë në seancën e ardhshme se çfarë masa janë marrë për ruajtjen e planit urbanistik në atë pjesë të qytetit.

Nuk pati debatues të tjerë lidhur me këtë informatë, kurse kryesuesi i falënderon të gjithë ata që dhanë vërejtje lidhur me këtë informatë.

7. Informatë për vlerësimin e aseteve të KRM “Higjiena”,

Izmi Zeka- ne e kemi dhënë një informatë edhe më parë, por tash komisioni ka punuar dhe informata është më plotë. Kryetari i këtij komisioni është z. Riad Rashiti i cili do të na informojë për vlerësim të aseteve në KRM “Higjiena”

Riad Rashiti- Lidhur me vlerësimin e aseteve z. Rashiti e dha një informatë para anëtarëve të Kuvendit të cilën e dorëzoi me shkrim në sekretari, por e cila do të jetë pjesë e procesverbalit.

Sokol Haziri- unë kam qenë zv/kryesues i këtij komisioni nga grupi parlamentar i AAK-së. Unë dëshiroj t' i them dy gjëra; e para po e theksoj bashkëpunimin e mirë me të gjithë kolegët të cilin e kemi pasur në komision dhe kompetencën e këtij komisioni e cila është fuqizuar me ndihmën e këtij Kuvendi. Autoritet i vetëm që është dashur të veprojë legalisht është ky komision në bashkëpunim me kompaninë e specializuar për vlerësim të aseteve. Ky proces me formim të komisionit duhet të përfundojë, mirëpo ndërhyrje kanë qenë të karakterit të palejueshëm të cilat nuk kam pasur mëdyshje se nuk duhet të trajtohen si partner, por vetëm si informues nga zyra përkatëse e cila i ka shtrirë duart më larg se sa i takon dhe në këtë aspekt kemi qenë unik të gjithë anëtarët e komisionit. Unë dëshiroj të them që këtij komisioni t' i epet një zgjidhje, qoftë deri në përfundim të mandati për të cilin unë jam ose në variantin më të thjeshtë të shkohet si komision i cili e monitoron këtë proces në vazhdim(nuk merr masa tjera, por monitoron).

Ato konkluzione të cilat i lexoi Riadi janë në interes të Kuvendit për t' i mbështet, por edhe në interes të qytetarëve, sepse ne dëshirojmë që mos t' i mbyllet rruga investimeve, të punohet, por të punohet në interes të qytetarëve. Me variatin me të cilin janë propozuar nga ajo zyre ka interesim të madh nga vetë anëtarët e këshillit për ta marrë me qira një kompani të tillë. Prandaj shumë seriozisht i sugjeroj këtij Kuvendi që të merret më për së afërmi ta monitorojë këtë proces, sepse dyshimet janë bukur të bazuara.

Unë kërkoj që të rimandatohet komisioni përkatës për monitorim të procesit ose të përfundojë puna, sepse unë nuk jam më i interesuar për të qenë pjesë e këtij procesi nëse shkojnë punët si deri më tani.

Arben Mehmeti- unë e përshëndes raportin e komisionit dhe më në fund më vjen mirë që është konstatuar një fakt mjaft interesant që ka ndodhur në Komunën e Gjilanit.

Siç po shihet është krijuar një klimë e që realisht dëshiron për ta anashkaluar KK-në dhe ka tentime të veprojë në kundërshtim me qëndrimet e këtij Kuvendi.

Fatmirësisht ne e kemi paralajmëruar një situatë të tillë edhe më herët dhe kjo po shihet edhe nga konstatimi i këtij komisioni. Është mirë që Kuvendi t' ia bëjë me dije edhe drejtorive dhe zyrave përkatëse se kanë obligim ligjor për t' i zbatuar vendimet e këtij Kuvendi dhe kanë obligim ligjor për t' i zbatuar misionet e komisioneve të cilat dalin prej këtij Kuvendi. Çdo mandat që i epet Kuvendit, nga ky organ ata e kanë përgjegjësinë më të madhe se zyrat dhe më madhe se drejtoritë për të vendos për çështje të caktuara për pa e cenuar ligjin.

Sa i përket mandatis të këtij komisioni, unë mendoj se duhet t' i ndërprehet mandati sa i përket vlerësimit të asteve të kompanisë dhe t' i epet mandati për ta monitoruar të tërë këtë proces dhe pasi që të kalojë në PP së paku për çdo vit të japin raport se si funksionon kjo kompani a ka vërejtje dhe a janë duke u zbatuar vendimet konkrete të Kuvendit dhe të ligjit përkatës për PP. Unë propozoj që t' i ndërrohet mandati këtij komisioni, i njëjti ta vazhdojë punën, por ta përcjell, monitorojë dhe këshillojë këtë proces të PP-së.

U tha se "Higjiena" njësia në Viti e ka shkaput partneritetin me atë Gjilanit, por unë kam informata se Vitia ka bërë kërkesë për t' i bashkëngjit njësisë së Gjilanit dhe ka mundësi që edhe Vitia të jetë pjesë e këtij projekti.

Sadudin Berisha-kryesuesi i komisionit i dha informatën për vlerësim të asteve të KRM "Higjiena", por ky Kuvend në dy periudha ka nxjerr dy vendime të ndryshme. Një është

vendimi i parë mbi vlerësimin e aseteve, me përfaqësues të subjekteve politike për anëtarë të komisionit, por këtij komisioni iu është vazhduar mandati për hapje të procedurave për hyrje në partneritet të PP-së, paraprakisht është marrë vendimi për të hyrë në PP si arsye dhe nevojë për zhvillimin kësaj veprimtarie e që është veprimtari e ndjeshme në Komunë. Mirëpo unë në takimin e fundit e kam thënë se asnjë ndërhyrje, pavarësisht dëshirës, kërkesave të grupeve për formacion tjetër që bie ndesh me vendimet e Kuvendit nuk mund të lejohen kush do që të jetë në pyetje. Komisioni i ka kryer obligimet e veta, por duhet edhe institucionet e tjera përgjegjëse të Komunës, t' i bëjmë me dije se çdo ndërhyrje është abuzim, është thjeshtë është në kundërshtim me çdo normë, morale, njerëzore, por mbi të gjitha ligjore. Kërkoj që nga kryetari i Komunës, Kuvendi i Komunës që t' i bëjë thirrje atyre të cilët ndoshta nuk e kanë asnjë mandat të caktuar të mos ndërhyjnë ashtu siç kanë ndërhyrë. Është shumë cinike dhe qesharake të cenohet një institucioni i zgjedhur nga KK dhe thjeshtë të cenohet autoriteti i KK-së. Kjo duhet të ndërpritet nga kush do që vijnë, çfarëdo kërcënime që të vijnë ato janë kërcënime boshe dhe nuk duhet lëshuar pe kur është në pyetje ligji.

Zijadin Maliqi- unë kam lexuar materialin me vëmendje, por një çështje në fund ku i pash dy emrat e anëtarëve të komisionit të cilët kanë dhënë një vlerësim të cilën e sqaroi Riadi punën e tyre. Lidhur me vlerësimin e aseteve komisioni e paska dhënë mbi 800 mijë euro, kurse sipas tyre vlera e aseteve është afër 5900 mijë uro, por thuhet se kjo vlerë mund të lëvizë, sepse ka të hyra edhe prej tregut. Unë nuk e kam të qartë se sa është vlera e aseteve e saktë? Sipas Higjienës, komisioni e ka marrë prej bilancit të gjendjes së Higjienës është bukur më e madhe se sa e ka dhënë ajo ndërmarrje e cila është autorizuar për vlerësim të aseteve. Gjithashtu e kemi edhe gjendjen financiare të Higjienës të cilin rast ne nuk kemi pasur rast ta shohim asnjëherë edhe pse me ligjin mbi ndërmarrje publike thuhet se komisioni komunal për aksione duhet ' i përgjigjet KK-së, por ne asnjë informatë në baza vjetore nuk e kemi pasur asnjëherë. Nga kjo po shihet se ne këshilltarët komunal respektohem vetëm kur ne iu duhem atyre, përndryshe ne për ta nuk ekzistojmë fare. Jemi të interesuar si KK- që ta dimë gjendjen e ndërmarrjeve publike të cilat ekzistojnë në Komunë.

I përkrahim të gjitha konkluzionet të cilat i propozoi kryetari i komisionit.

Ejup Haziri- edhe ne si grup qëndrojmë prapa konkluzioneve që i dha kryetari i komisionit, por ndiejmë keqardhje për Zyrën e PP-së dhe raportet e tyre me komisionin. Ne qëndrojmë prapa atyre propozimeve të cilat janë bërë, por edhe të atyre që eventualisht do të jenë në të ardhmen, si zgjidhje mundshme.

Analiza e cila u bë për këtë zyre e cila ka propozuar një qira prej 500 eurove, mbi të gjitha komisioni duhet pasur parasysh se interesi i qytetarit është kryesorë dhe një nga kompanitë më të mira dhe më profitabile të cilat mund të llogariten e të cilat janë rentabile dhe ende janë publike dhe shoqërore është kompania "Higjiena". Nëse në formë perfide tentohet për ta humbur, atëherë, nuk është humbje e vogël, por është humbje e pa riparueshme.

Arben Malqi- edhe grupi i jonë e përshëndet këtë informatë dhe ka besim të plotë në anëtarët e vet, nuk po flas për anëtarët që nuk janë në radhët tona. Mirëpo unë i kam disa informata jo zyrtare se diçka është duke u zier këtu, por se çka nuk e di!

Riad Rashti- sa për informatë po e them se këtë çështje nuk ka nevojë për ta politizuar, por as nuk ka kërcënim nga askush, për cilin gjë iu garantoj. Këtu ka ndërhyrje të kompetencave të pozicioneve se çfarë i kanë.

Kërkesës së Arbenit për t' iu dhënë një mandat i ri këtij komisioni besoj se nuk ka nevojë, sepse ky komision është formuar me vendim të KK-së me 29 mars 2011.

Sa i përket Vitisë është çështje ligjore, ajo deri më tash dhe deri para tri vite ka funksionuar si e pavarur, mirëpo të drejtën e hyrjes në PP të njësisë së Vitisë e cakton ligji. Kjo saktë definohet dhe secili komision komunal ka të drejtë të marrin vendim duan apo nuk duan të hyjnë në këtë proces. Ata me vendim të komisioneve përkatëse duhet të na drejtohen neve duan apo të jenë në partneritet me neve.

Arsyeja pse është një diferencë e tillë e vlerësimit të asteve të cilën e theksoi Zijadini është se në listën e asetëve të Higjienës është llogaritur toka dhe Tregu i Gjelbër si pronë e tyre. Nga fletë posedimet shihet se toka dhe Tregu i Gjelbër figurojnë si pronë e Higjienës. Shuma 800 mijë euro nuk është vlerë reale e kompanisë, sepse kjo shifër është vetëm vlera e asteteve fikse.

Izmi Zeka – nga praktika po e them në fund se institucionet komunale dhe ato shtetërore që kur të bëhen propozime, ato duhet të vijnë në KK. A e miraton apo jo Kuvendi, mandej a bënë ndërhyrje apo jo është çështje e Kuvendit?

Në rastin konkret dy herë kemi votuar, dy vendime janë, konkluzionet janë të komisionit dhe jo të njësisë së PP-së.

Këto konkluzione janë të institucioneve komunale, njësia mund të jep propozime dhe nëse komisioni i aprovon i bie në Kuvend dhe Kuvendi i shqyrton.

Njësia e PP-së e ka të drejtën e propozimeve, të cilat propozime ne i shqyrtojmë dhe marrim vendime.

Komisioni ta vazhdojnë punën, por duhet harruar nuk ka me qira.

Komisioni është mirë që çdo muaj të na informojë se çka po ndodh.

Sokol Haziri- dua ta jap një sqarim, unë nuk do t' i jap llogari asnjëherë asaj njësie dhe ata do të i japin llogari këtij komisioni kur vetëm ne i kërkojmë ndonjë sqarim ose informatë. Ata nuk janë partner tanë në kuptimin e vendimmarrjes.

Izmi Zeka- ai sektor iu ndihmon dhe ai e ka obligim të merret edhe me këtë çështje dhe nëse ka propozime të cilat e lehtësojnë punën e juve duhet pasur ato gjëra parasysh.

Riad Rashiti- ne jemi të varur prej institucioneve dhe zyrave të tjera, sepse ne nuk kemi as kompetenca as mandat për të shpallur tender për aplikime. Është njësia e prokurimit që i përgjigjet kërkesave tona, kur ne të jemi të gatshëm për ta përgatitur lëndën për të shkuar në tenderim. Njësia për PP është themeluar për këtë qëllim dhe ne i kemi dërguar një kërkesë që të bëjë propozimin e kriterëve dhe dokumentacionit që ne si komisioni t' i kemi të gatshme për t' i analizuar, pastaj t' i dërgojmë në KPF dhe Kuvend.

Në kërkesën tonë Higjiena nuk është përgjigj, prandaj e lus kryesuesin e Kuvendit t' ia dërgojnë një shkresë dhe t' i njoftoj se ata janë të obliguar për të bashkëpunuar me neve.

Izmi Zeka – lidhur me këtë që e tha Riadi unë e marrë për obligim dhe i rregulloj këto gjëra.

Lidhur me këtë pikë nuk pati debatues të tjerë dhe informata mori fund

8. Raport nga takimi i KKSB

Izmi Zeka- raporti iu është dërguar anëtarëve të Kuvendit, për të cilin nuk pati debatues, kurse për aprovim nuk kishte nevojë sepse kjo ishte informatë.

9. Propozim vendimi për lirim nga pagesa për leje ndërtimore për kategorinë e qytetarëve të dëmtuar nga tërmeti,

Pika e 9 e rendit të punës është shtyrë me pëlqim të anëtarëve të Kuvendit

10. Informatë rreth gjendjes energjetike në Komunë,

Gjithashtu edhe pika e 10 e rendit të punës me pëlqim të anëtarëve të Kuvendit është shtyrë për seancën tjetër.

5. Të ndryshme,

Seanca përfundoi punimet në ora 17

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA